



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 67/10 prot.

Tiranë, 8.2.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besnik Cani
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 25.1.2019, është njoftuar vendimi nr. 84 datë 27.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim z. Besnik Cani, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Referuar këtij vendimi, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “c” e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 25.1.2019, është depozituar akti: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të ONM-së.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, ushtron detyrën e prokurorit dhe, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Duke qenë se subjekti ishte kandidat (aktualisht anëtar) i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bazuar në nenin 279, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi në kohë.
2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim referuar si GPPP), nga të cilat rezulton se:
 - 2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Besnik Cani”, ka referuar:
 - i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - 2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës” për subjektin.
 - 2.3 GPPP, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale.
3. Referuar rezultateve të hetimit administrativ¹, rezulton se, fillimisht, Komisioni, me anë të vendimit të ndërmjetëm nr. 2, datë 20.7.2018, ka vendosur që hetimi të mbyllet vetëm mbi kriterin e pasurisë, duke njohur subjektin me gjetjet dhe kalimin e barrës së provës ndaj tij. Por, me vendimin nr. 3, datë 7.8.2018, pasi administroi shpjegimet e subjektit, Komisioni ka vendosur rihapjen e hetimeve. Bazuar në nenin Ç/1, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka gjykuar që procesi i rivlerësimit për subjektin z. Besnik Cani të bazohej dhe përfundojë për të tria kriteret e rivlerësimit. Me vendimin nr. 4, datë 15.11.2018, Komisioni ka vendosur të rimbyllë hetimin administrativ për të tria kriteret. Pasi ka njohur subjektin me rezultatet e hetimit, provat e administruara, Komisioni i kaluar sërish barrën e provës më datë 15.11.2018.

¹ Hetimi administrativ i Komisionit është zhvilluar gjatë periudhës 14.12.2017 - 15.11.2018.

Më datë 20.11.2018, Komisioni administroi shpjegimet e subjektit dhe, me vendimin nr. 5, datë 21.11.2018, njoftoi subjektin për zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 23.11.2018.

4. Hetimi, vlerësimi dhe përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 **Për vlerësimin e pasurisë**, bazuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe kreun IV, të ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ ka konsistuar në kontrollin dhe vlerësimin e saktësisë, mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të. Nga ky hetim ka rezultuar se provat dhe faktet e dala kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, shkak për të cilin subjektit të rivlerësimit i ka kaluar **barra e provës**, në bazë të nenit Ç, pika 5, dhe D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën mbi çështjet si vijon²:

4.1.1 Lidhur me truallin dhe banesën e ndërtuar pa leje dhe të legalizuar në ***:

- Ka mungesë deklarimi të posedimit të tokës në periudhën 2003 - 2007;
- Ka mospërputhje midis deklaramëve të subjektit lidhur me sipërfaqen e tokës dhe shtëpisë, të vetëdeklaruar për legalizim, si dhe mbi periudhën e ndërtimit të shtëpisë në fjalë;
- Ka mospërputhje midis sasisë së sipërfaqes së kërkuar për legalizim sipas referencave të sipërfaqes të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me sipërfaqet e legalizuara konkretisht;
- Dysohet se subjekti mund të ketë pasur përfitime përtej parashikimeve në lidhje me sipërfaqen e lejuar për legalizim nga normativat përkatëse – në saje të mosrespektimit të dispozitave ligjore në lidhje me sasinë e sipërfaqes së tokës së legalizuar, si dhe mbi çmimet e aplikuar për legalizimin/shitjen e saj;
- Ka mospërputhje midis të dhënave të lejes së legalizimit mbi numrat e pronësisë me ato që janë regjistruar në ZVRPP, e cila ka proceduar gjithsesi për regjistrimin e pasurive, pavarësisht këtyre mospërkimeve.

4.1.2 Lidhur me kontratën e qirasë së truallit në ***, Tiranë, me shoqërinë

“****”sh.p.k.:

- Rezultojnë mospërputhje midis deklaramëve të bëra nga shoqëria “****” sh.p.k. në shkresën e datës ***.1.2017, me përmbajtjen e shkresës datë ***.4.2018, në lidhje me datën e përfundimit të punimeve dhe të fillimit të aktivitetit në pikën e karburantit dhe ambientet (zyra, bar-kafe, lavazh) të ndërtuara në ***, mbi truallin në pronësi të subjektit;
- Mungesë deklarimi në deklaratën e vitit 2017, të një trajtimi preferencial ekzistues, që materializohet me kalimin e një të drejte fitimprurëse mbi sende të paluajtshme, pa asnjë kundërvlerë financiare, nga shoqëria “****” sh.p.k., te subjekti;
- Kontrata e “qirasë” me kohëzgjatje 25 vjet, me kushtin që në përfundimin e afatit të saj, shoqëria “****” sh.p.k. detyrohet të kalojë te subjekti i pronësisë mbi sendet e paluajtshme të ndërtuara nga shoqëria - së bashku me ndryshimet e mëpasshme të përmbajtjes së kontratës, prodhon efekte të shumëfishta dhe të ndryshme nga një kontratë e mirëfilltë qiraje, edhe pse formalisht marrëdhënia juridike mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit është konsideruar prej tyre si kontratë qiraje;

² Nga pikat 4.1.1 – 4.1.5 janë çështjet për të cilat subjektit i është kaluar barra e provës më datë 20.7.2018.

- Heqja dorë e shoqërisë “****” sh.p.k. nga e drejta 25-vjeçare për përdorimin e lokalit bar-kafe dhe lavazh, për ushtrimin e aktivitetit tregtar të parashikuar për t’u kryer në këto ambiente dhe kalimi i kësaj të drejte te subjekti i rivlerësimit, pa asnjë kundërvlerë financiare, përbën një trajtim preferencial të padeklaruar në formularin përkatës nga subjekti;
- Vlera financiare e fitimeve të realizuara nga këto aktivitete tregtare, në nëntëmujorin e parë të përdorimit të tyre nga subjekti (prill-dhjetor 2017), vjen në kontradiktë me qëndrimin e shoqërisë “****” sh.p.k., se aktivitetet mbështetëse nuk ishin me interes ekonomik;
- Trajtimi preferencial mund të përbëjë shkak papajtueshmërie me profesionin e prokurorit dhe/ose mund të përbëjë një konflikt interesi në saje të urdhrit nr.141/2014, të Prokurorit të Përgjithshëm..., si dhe mund të konsiderohet si një mosrespektim i kufizimeve të parashikuara nga ligji nr. 96/2016. Kjo rrethanë komplekse eventualisht cenon etikën profesionale në kryerjen e detyrës nga ana e magjistratit/prokuror, si dhe sjell si pasojë humbjen e besimit të publikut te figura e një magjistrati/prokurori të Republikës.

4.1.3 Lidhur me apartamentin e banimit me sip.117 m², në rr. “****”, Tiranë:

- Ka pasur mungesë burimesh financiare në shumën 534.454 lekë, si pjesë e kështit të parë prej 21.000 euro, paguar në datë ***.9.2005, në favor të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.;
- Deklarim i pamjaftueshëm për shkak të mosdeklarimit në vitin 2004 të depozitës bankare prej 3.500 \$, në një nga bankat e nivelit të dytë;
- Në vitin 2005 rezulton një deklaram të ardhurash prej 104.409 lekë, më shumë sesa të ardhurat e dokumentuara.

4.1.4 Lidhur me veprimet financiare - tregtare:

- Rezulton se shuma e marrë hua nga baxhanaku i subjektit, z. ***, në periudhën 2005 – 2009, është vetëm 850.000 lekë (nga të cilat 250.000 lekë ndërkohë ishin shlyer) dhe jo 1 milion lekë, sa është deklaruar;
- Rezultojnë mospërputhje (i) mes deklaratës “*Vetting*” dhe deklaratave periodike, (ii) mes deklaratave periodike dhe deklaratave noteriale të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, (iii) mes deklarimit të subjektit të datës 27 janar 2017 dhe deklarimit në pyetësorin e datës 25 mars 2018, (iv) midis detyrimit financiar prej 600.000 lekë, që rezulton në fund të vitit 2016 dhe vlerës prej 1 milion lekë, të deklaruar si detyrim në deklaratën “*Vetting*” dhe (v) mes deklarimit për shlyerjen e shumës prej 1 milion lekësh dhe faktit se detyrimi financiar ishte 600.000 lekë;
- Në vitin 2002 është blerë nga subjekti një automjet me vlerë të deklaruar 200.000 lekë dhe në vitin 2007 është shitur nga subjekti i njëjti automjet me vlerë të deklaruar 350.000 lekë, duke u evidentuar një mospërputhje mes çmimit të blerjes me çmimin e shitjes së automjetit, me ecurinë e çmimeve të tregut, pas katër viteve përdorim (amortizimi i automjetit).

4.1.5 Nga analiza financiare:

- Rezulton me mungesë burimesh të ardhurash të ligjshme financiare për vitet 2005, 2006, 2007, 2009-2013 dhe 2015, të cilat duhet të ishin të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet dhe investimet e kryera ndër vite, si dhe për të realizuar kursimet e deklaruara nga subjekti;
- Rezultojnë deklarime të pasakta, të paplota dhe të pamjaftueshme ndër vite, si më sipër.

4.1.6 Sikundër u parashtrua më lart, pas rihapjes së hetimit administrativ nga Komisioni, subjektit i ka kaluar barra e provës (datë 15.11.2018), përveç sa më sipër, edhe për çështjet si vijojnë:

- Nga analiza financiare, konstatohet mungesë burimesh të ligjshme financiare, në vitet 2005, 2006, 2010, 2011-2013 dhe 2015. Mungesa totale e burimeve financiare gjatë 6 viteve, që rezultojnë me bilanc negativ, është në shumën – 947.917 lekë.

4.1.7 Rezultojnë deklaratime të pasakta dhe të pamjaftueshme ndër vite, siç specifikohet në analizën financiare (të Komisionit).

4.2 Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, pasi zhvilloi seancën dëgjimore me subjektin, në vendimin e tij arsyeton se: “... subjekti i rivlerësimit ka kryer pasaktësi në deklaratimet periodike, por pa pasur si qëllim apo si pasojë fshehje të pasurisë, apo mosdeklarimin e burimit financiar të përdorur për blerjen e ndonjë pasurie. Kanë rezultuar disa **mangësi të burimeve financiare** - për një total të akumuluar në pesë vite (dhe të shpërndara në harkun kohor 11-vjeçar), në shumën prej 819.812 lekësh, të cilat konsiderohen jo të mjaftueshme që të passjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Nuk është konstatuar fshehje pasurie”.³

5. **Për kontrollin e figurës**, bazuar në nenin DH, të aneksit të Kushtetutës dhe kreun V, të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi administrativ i Komisionit nuk janë gjetur elementë që të vërtetojnë apo ngrenë dyshime të arsyeshme mbi kontakte të papërshtatshme të subjektit. Sipas Komisionit, subjekti është gjendur në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

6. **Për vlerësimin e aftësive profesionale**, bazuar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës, nenin 43/2 dhe 44, të ligjit nr. 84/2016, Komisionit pas (i) administrimit dhe analizimit të raportit të përgatitur nga GPPP, (ii) vlerësimit dhe hetimit të 6 denoncimeve nga publiku, i ka rezultuar se provat dhe faktet e dala kanë nivelin e provueshmërisë, referuar nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, shkak për të cilin subjektit të rivlerësimit i ka kaluar **barra e provës** (datë 15.11.2018) në bazë të nenit Ç, pika 5, nenit E të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën për (7) çështjet si vijon:

6.1 (c) Nga 5 dosjet penale të përzgjedhura me short, ndryshe nga përfundimet e pasqyruara në raportin e GPPP-së, Komisioni ka evidentuar mangësi në aspektin e vlerësimit profesional të subjektit. Kështu, **për dosjen nr.***, çështja penale nr.***, viti 2015** - vendimi i datës

³ Qëndrimi i Komisionit nuk mban parasysh jurisprudencën e Kolegjit, ku në vendimin nr.7/2018, për subjektin e rivlerësimit, z. *** ***, argumentohet se:

[“75. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklaratimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit. Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në shtojcën 2, të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), e cila ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor. **Në lidhje me deklarinë e pasurisë, ligji nuk ka pasur në qëllim të tij përcaktimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, të lidhura me dashjen apo qëllimin, pasi në të kundërt do të kishte bërë përcaktime të tilla, si në nenin 38 për standardet e kontrollit të figurës.**

76. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, shkarkimi i gjyqtarit, ashtu si në rastet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, kryhet nga Komisioni pas një procesi hetimi të bazuar në prova, të cilat sipas nenit 32, pika 4, mund të jenë edhe deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja. Kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, i shërben Komisionit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij”.]

..2015, “Për shfuqizimin e akteve të çështjes penale”, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezulton se hetimet nuk kanë qenë të thelluara, faktet nuk janë vlerësuar juridikisht në mënyrë korrekte, rikualifikimi i veprës penale ka qenë i gabuar, përcaktimi/citimi i bazës ligjore të zbatueshme në rastin konkret ka qenë i gabuar.

6.2 (d/1) **Për etikën profesionale (kontrata/marrëdhënia juridiko-civile - subjekt – shoqëria “****” sh.p.k.):**

- Kontrata në fjalë nuk mund të konsiderohet një kontratë qiraje, pasi ajo nuk i përmban elementet përbërëse të një kontrate qiraje të parashikuar nga Kodi Civil;
- Kontrata e “qirasë” me kohëzgjatje 25 vjet, me kushtin që në përfundimin e afatit të saj, shoqëria “****” sh.p.k. detyrohet të kalojë te subjekti i pronësisë mbi sendet e paluajtshme, të ndërtuara nga shoqëria- së bashku me ndryshimet e mëpasshme të përmbajtjes së kontratës-prodhon efekte të shumëfishta dhe të ndryshme nga një kontratë e mirëfilltë qiraje, edhe pse formalisht marrëdhënia juridike mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit është konsideruar prej tyre si kontratë qiraje;
- Marrëdhënia juridiko civile mes subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. ka veçoritë ligjore të një pjesëmarrje në një shoqëri të thjeshtë, ku secila palë sjell një send apo kryen një investim dhe pastaj fitimet ndahen nga ortakët, sipas marrëveshjes të arritur mes tyre, dhe për rrjedhojë përfitohen shuma në saje të realizimit të fitimeve nga shoqëria falë mbarëvajtjes së aktivitetit ekonomik, pra subjekti nuk krijon të ardhura si pasojë e përmbushjes së një detyrimi kontraktor të qiramarrësit për të paguar qira mujore, me një vlerë financiare fikse dhe të paracaktuar në kontratë;
- Gjithashtu duhet specifikuar fakti që pranimi i së drejtës të përdorimit të ambienteve të ndërtuara nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe krijimi i të ardhurave financiare, krijimi dhe administrimi i një biznesi të tillë, si dhe mënyra se si është kontraktuar/formalizuar dhe administruar e gjithë kjo marrëdhënie, që ka prodhuar dhe prodhon përfitime financiare për familjen e subjektit të rivlerësimit, mund të sjellë si pasojë lindjen e dyshimeve mbi një përfitim eventual nga detyra e subjektit;
- Sa më lart, mund të përbëjë shkak papajtueshmërie me ushtrimin e detyrës së prokurorit dhe/ose mund të përbëjë një konflikt interesi⁴ bazuar në urdhrin nr.141/2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, dhe po ashtu mund të konsiderohet si mosrespektim i kufizimeve të parashikuara nga ligji nr. 96/2016. Kjo marrëdhënie mes subjektit dhe shoqërisë në fjalë mund të përbëjë shkak të cenimit të etikës profesionale dhe humbjen e besimit të publikut te figura e magjistrati/prokurori në Republikën e Shqipërisë.

6.3 (d/2) **Aplikimi për kredi të butë në Bashkinë Fier⁵, përfitimi i statusit të familjes pa strehë:**

- Duke aplikuar dhe duke kryer të gjitha veprimet e parashikuara nga normativa ligjore për përfitimin e një kredie të butë, Komisioni ka konsideruar se subjekti ka përdorur funksionin e tij, si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, për të përfituar trajtime financiare, që nuk

⁴ Në lidhje me ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit, KPK-ja ka kërkuar një vlerësim nga ILDKPKI-ja, ku kjo e fundit, me shkresën nr. *** prot., datë ***.4.2018, ka vlerësuar se nuk shihej prania e një konflikti interesi në rastin konkret.

⁵ Në lidhje me këtë çështje, Komisioni ka marrë dëgjimin fillimisht nga një shkrim në një portal mediatik, ku dhe më pas ka hetuar, duke administruar Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 14, datë 28.3.2013. Në këtë vendim ka figuruar se bashkëshortja e subjektit është përfshirë/ka përfituar statusin e familjes pa pastrehë, me qëllim përfitimin e kredive të buta nga shteti. Ndërkohë duhet theksuar se subjekti ka qenë drejtues i Prokurorisë pranë këtij rrethi, ku mbi këtë çështje ka pasur kallëzim dhe procedim penal (mosfillim i hetimeve në vijim të kallëzimit penal nr.***/2012).

mund t'i përfitonte bazuar në kërkesat e ligjit, për vetë subjektin dhe personat që lidhen me të dhe, rrjedhimisht, këto veprime mund të kenë cenuar figurën e magistratit/prokurorit dhe humbjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

6.4 Denoncimet nga publiku. Shtetasi *.***. Çështja penale nr.***, e vitit 2007, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë:**

- Komisioni ka konstatuar se subjekti në hetimin e kësaj çështjeje ka pasur mangësi profesionale lidhur me thellimin e hetimeve, mungesë arsyetimi dhe marrje vendimi pushimi "sipërfaqësor" dhe, më vonë, pas kryerjes së hetimeve të mëtejshme nga po ai prokuror - por në saje të urdhrin të drejtuesit të tij - vetë subjekti arrin në konkluzion të kundërt, duke kërkuar gjykim për të njëjtat fakte që kishte pushuar çështjen.

6.5 Denoncim nga shtetasi *.***. Vendimi për pushimin e procedimit penal nr.***/2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër:**

- Komisioni ka ngritur dyshime mbi mungesën e hetimeve të thelluara dhe mosarsyetim në lidhje me faktin dhe shkaqet e hetuara.

6.6 Denoncim nga shtetasi *.***⁶. Vendimi për mosfillim të procedimit penal nr.***/2006, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë:**

- Komisioni ka konstatuar mangësi në kryerjen e hetimeve, pasi në disa raste janë marrë vendime mosfillimi ose pushimi dhe më pas - në vijim të prishjes së tyre, në saje të hetimeve të kryera, është arritur në konkluzione të kundërta nga vetë subjekti;
- Vlerësim i gabuar i fakteve ose referim i gabuar i bazës ligjore;
- Komisioni ka konstatuar se kompetenca hetimore nuk është ushtruar plotësisht dhe në mënyrat e parashikuara nga dispozitat ligjore, nënligjore, urdhëresat etj., ka pasur uzurpim të kompetencës së prokurorit titullar...etj.

6.7 Nga hetimi administrativ i Komisionit. Vendimi për pushimin e çështjes, datë *.***.2014, për procedimin penal ***, i vitit 2014, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan:**

- Komisioni konstaton se subjekti nuk arsyeton dhe shprehet mbi njëjërën nga veprat për të cilat është regjistruar procedimi penal.

6.8 Komisioni, pas administrimit dhe vlerësimit të pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën, në lidhje me rivlerësimin e aftësi profesionale, në vendimin e tij arsyeton se: "... pavarësisht vlerësimit pozitiv të Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni ka konstatuar disa problematika lidhur me aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, si dhe disa dyshime të arsyeshme në lidhje me etikën - të cilat gjithsesi nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se z. Besnik Cani nuk arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, dhe për këtë arsye trupi gjykues çmon që, në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë të gjitha praktikat/dosjet/aktet me dyshime apo problematika, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore...".

⁶ Referuar rezultateve të hetimit, Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë ***.10.2018, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kërkuar dosjen hetimore të procedimit penal nr.***, të vitit 2009, për kallëzimin penal nr. ***/2007.

7. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli për rivlerësimin e magistratit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka vendosur (ndër të tjera si pjesë e dispozitivit):

“- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

- Në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë disa çështje/praktika pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, si më poshtë vijon:

- a. Praktika e marrëdhënies juridiko - civile ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k.;
- b. Çështja me nr. ***, e vitit 2006, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- c. Dosja e procedimit penal me nr. ***, e vitit 2012, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të patrehë, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr. 14, datë 28.3.2013;
- d. Çështja me nr. ***, e vitit 2015, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan....”.

II. Shkaqet e ankimit

8. Në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).
9. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).
10. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 – 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.
11. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.
12. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së (bashkëlidhur këtij ankimi), çmon se ky vendim është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të dispozitave kushtetuese dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, si dhe bazohet në një vlerësim jo të drejtë të provave të administruara. Në referencë të zbatimit të dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm, lidhur me faktin (et) për çështjen objekt ankimi, Komisioneri Publik vlerëson se ky vendim i Komisionit është i cenusshëm në

tërësinë e tij, shkak për të cilin i kërkohet Kolegjit të ushtrrojë juridiksionin e tij kontrollues dhe rivlerësues, duke e ndryshuar atë.

13. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni, sa i takon kriterëve të rivlerësimit, bazuar në kërkesat e dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, Komisioneri Publik konstaton se përfundimet e arritura nga Komisioni janë të gabuara dhe jo në pajtueshmëri me provat e administruara.
14. Në këtë drejtim, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (periodike dhe ajo *Vetting*), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe personave të lidhur. Me pasuri të ligjshme (e paluajtshme/e luajtshme/likuiditetet), për qëllim të këtij përcaktimi kushtetues, konsiderohen vetëm ato të cilat janë deklaruar (saktësisht dhe mjaftueshmërisht) dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.
15. Ndërsa objekti i vlerësimit për kriterin e aftësive profesionale, materializohet në kontrollin dhe hetimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht ligji nr. 96/2016. Në të njëjtën normativë ligjore gjen rregullim dhe objekti i vlerësimit i kriterit të figurës së subjektit të rivlerësimit.
16. Për rastin objekt ankimi, Komisioneri Publik vëren se, megjithëse Komisionit i kanë rezultuar rrethana dhe fakte të provuara, subjekti:
 - (i) *Për kriterin e pasurisë*, nuk ka dhënë prova konkrete dhe shpjegime bindëse lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës në ***, ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme ndër vite, si dhe rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme financiare;
 - (ii) *Për kriterin e aftësive profesionale* kanë rezultuar fakte (marrëdhënia juridiko-civile-subjekt - shoqëria “***” sh.p.k.), mangësi të përsëritura dhe modele të papërshtatshme pune, të cilat janë në papajtueshmëri dhe cenojnë figurën dhe etikën e prokurorit të Republikës;

duke u bazuar në interpretime dhe zbatim të gabuar të dispozitave të aneksit kushtetues, ligjit të posaçëm dhe vlerësimit jo objektiv të fakteve, udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit, zbatimi i të cilit (*parimi i proporcionalitetit*) në gjykimin e Komisionerit Publik nuk është i përshtatshëm në rrethanat konkrete të provuara, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit z. Besnik Cani.

17. Në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mangësi dhe mospërbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe legjislacionin e posaçëm, për kriteret e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se, nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin konkret duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 3, 4 dhe 5 të këtij ligji.

18. Referuar sa më lart, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon të gjitha elementet e vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II.A Pranueshmëria e ankimit

19. Përpara se të vijojmë me trajtimin e çështjeve objekt ankimi dhe për të cilat Kolegji do duhet të shprehet në zbatim të juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të tij, paraprakisht Komisioneri Publik çmon të sqarojë kushtet e pranueshmërisë së këtij ankimi, i cili ushtrohet kundër vendimit të Komisionit në tërësinë e tij, përfshirë katër çështjet e referuara organit kompetent për inspektim.
20. Neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përcakton se: *“Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim (i) në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve (ii) ose në rast se evidenton shkaqe për t’u marrë parasysht gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim. Organi kompetent fillon menjëherë shqyrtimin e shkaqeve, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.*
21. Nga leximi i parë literal i kësaj dispozite, duket sikur ndalimi i së drejtës së ankimit në rastet kur neni 59/4, i ligjit nr. 84/2016, ka gjetur zbatim në dispozitivin e vendimit të Komisionit, sikurse është edhe rasti konkret, ku Komisioni ka referuar 4 çështje/praktika⁷ pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, i shtrin efektet e tij dhe ndaj së drejtës kushtetuese të ushtrimit të ankimit nga Komisioneri Publik, por siç parashtrihen në vijim, ky interpretim eventual është i gabuar.
22. Komisioneri Publik vlerëson se ndalimi i parashikuar nga neni 59/4, i ligjit nr. 84/2016, për mosushtrim ankimi, i shtrin efektet e tij vetëm mbi palët që marrin pjesë në hetimin administrativ të kryer nga Komisioni, deri në përfundim të hetimit dhe shpalljen e vendimit përkatës për subjektin e rivlerësimit. Kjo dispozitë gjen zbatim në rastet kur subjekti është konfirmuar në detyrë nga ana e Komisionit për efekt të përfundimit të procesit kalimtar të rivlerësimit, por ndërkohë nga ana e këtij të fundit (Komisionit) janë evidentuar shkaqe që (mund të) përbëjnë shkelje disiplinore, e të cilat organi rivlerësues i konsideron jo të asaj shkalle dhe rëndësie, sa të vetme e në mënyrë të pavarur (neni 61/4) apo nga vlerësimi tërësor i çështjes (neni 61/5), të përbëjnë shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit, referuar nenit 58/1, germa “c”, dhe nenit 59, pika 2, lidhur me nenin 61/4, si dhe nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016.
23. Në vlerësim të Komisionerit Publik, parashikimi i pikës 4, të nenit 59, përveçse adreson të drejtën e organit rivlerësues, që, rast pas rasti, të referojë çështje pranë organit kompetent për inspektim në kushtet e mësipërme, njëkohësisht parashikon dhe ndalimin e së drejtës së ankimit për subjektin e rivlerësimit. Ky ndalim është proporcional dhe në balancë me të drejtat e subjektit, për sa kohë me transferimin e çështjes për shqyrtim organit kushtetues që gëzon juridiksionin disiplinor, ai (subjekti) do t’i nënshtrohet një tjetër procedure inspektimi disiplinor

⁷ Identifikuar si germa “a”, “b”, “c” dhe “d”, të pikës 1 në dispozitivin e vendimit të Komisionit.

dhe vlerësimi eventual pranë organit kushtetues. Gjatë kryerjes së këtyre procedurave të hetimit disiplinor, sikundër Kushtetuta urdhëron, subjektit të rivlerësimit i garantohen të gjitha të drejtat për një proces të rregullt ligjor, përfshirë të drejtën për ushtrimin e ankimit ndaj një vendimi eventual, që disponon marrjen e një masë administrative. Nga ana tjetër, në interpretim të Kushtetutës, ligjit të posaçëm, por dhe frymës së rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Venecias, vendosja e këtij ndalimi (mosushtrimi i së drejtës së ankimit) nga ligjvënësi mund të jetë materializim i nevojës që procesi i rivlerësimit, referuar nenit 4/3,⁸ të ligjit nr. 84/2016, të jetë një proces efektiv dhe i shpejtë në kohë, duke pamundësuar që subjektet e konfirmuara në detyrë nga ana e Komisionit, të mos vënë në lëvizje juridiksionin rivlerësues të Kolegjit, vetëm për shkak të transferimit të praktikës organit kushtetues përgjegjës për procedimin disiplinor.

24. Është e qartë se ndalimi i parashikuar në nenin 59/4 të ligjit nuk mund të veprojë mbi kufizimin e zbatimit të së drejtës kushtetuese për të ushtruar ankim, që i është njohur Komisionerit Publik (neni F, pika 2 e aneksit). Kur Komisioneri Publik, si një ndër organet rivlerësuese dhe përfaqësues i interesit publik, në referencë të nenit 179/b të Kushtetutës, çmon se vendimmarrja e Komisionit, rast pas rasti, nuk është në pajtueshmëri me ligjin dhe provat apo subjekti i rivlerësimit nuk është kushtet që duhet të konfirmohet në detyrë, ka të drejtën kushtetuese ta ankimojë vendimin pranë Kolegjit. I vetmi kufizim i së drejtës së Komisionerit Publik për të ushtruar ankim parashikohet edhe ai në nivel kushtetues, përkatësisht në nenin F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës. Kjo dispozitë përcakton kufizimin/ndalimin e së drejtës për të ushtruar ankim, vetëm në rastet kur Komisioni ka vendosur bazuar në nenin E, paragrafi 2,⁹ të këtij aneksi dhe/ose nenit 58, pika 1, germa “b”,¹⁰ e ligjit nr. 84/2016, vendimmarrje kjo e ndryshme nga ajo sipërcituar, bazuar në nenin 59/4 të këtij ligji.

III.A Vlerësimi i pasurisë

25. Si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë e gjejmë të materializuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e subjekteve që: (i) kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose (ii) nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin kushtetues për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.
26. Komisioneri Publik, ndryshe nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit për këtë kriter, në rastin konkret konstaton se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, që në kuptim dhe zbatim të nenit D, paragrafi 3, i aneksit të

⁸ Procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Kur çështja është gati për t'u shqyrtuar, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm.

⁹ Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim, identifikon mangësitë [...]

¹⁰ Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit... b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit [...]

Kushtetutës, ta bënte atë subjekt të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, e për pasojë të sillte konfirmimin në detyrë të tij.

27. Pasuritë nga subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Cani, janë deklaruar fillimisht në “*Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie*” (këtu e në vijim referuar si DV-20...), dorëzuar në ILDKP, më datë 20.3.2004, deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016, dhe në *Deklaratën “Vetting”* (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI, në datë 27.1.2017. Pasuritë e deklaruara janë si vijon:

28. **Pasuria nr. 1 - Në D-Vett. deklarohet:** “Apartament”, me sipërfaqe 104.77 m², nr. pasurie ***, z.k. ***, vol.***, fq. ***, rr. “****”, Tiranë, blerë për vlerën 8.308.261 lekë, sipas kontratës noteriale të shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2008, me pjesë takuese 100% në pronësi të subjektit. Si burim i krijimit të pasurisë deklarohet: (i) kursime nga të ardhurat personale dhe të bashkëshortes, (ii) detyrimet familjare etj. (iii) kredi bankare e marrë *** Bank, në shumën 40.000 euro, (iv) kursime ndër vite, (v) hua pa interes në shumën 6.000 euro, nga baxhanaku z.*** ***, me vendbanim në Greqi.

Në DV-2005 nga subjekti deklarohet: “Apartament” banimi, me sipërfaqe 117 m², rr. “****”, bazuar në kontratën noteriale të sipërmarrjes të vitit 2005, për vlerën 69.000 euro, pjesa takuese e subjektit 50%. Deri në deklarimin e këtij viti, subjekti ka shlyer pjesërisht vlerën e apartamentit prej 21.000 euro dhe si burim i krijimit të pasurisë deklarohet: (i) 3.500 USD, kursime të mbartura nga viti 2004; (ii) 6.000 euro hua, marrë nga baxhanaku në Greqi; (iii) hapje-mbyllje depozite në shumën 50.000 lekë; (iv) 500.000 lekë, marrë tek të afërmit, pa afat dhe pa interes, (v) kursimet e vitit 2005, në shumën 1.050.000 lekë.

28.1 Nga verifikimi i këtyre akteve, administruar si provë nga ana e Komisionit, në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, mes të tjerash, rezulton se deklarimi i burimit të krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, është i ndryshëm. Në D-Vett, subjekti nuk ka deklaruar saktësisht burimin e krijimit të saj, pasi nuk rezulton të këtë deklaruar huan në vlerën 500.000 lekë, deklaruar në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2005.

28.2 Nga aktet e administruara në dosje rezulton po ashtu se, në datë ***.9.2005, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, dhe shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, kanë lidhur një kontratë sipërmarrje me objekt ndërtimin e pasurisë “Apartament”, me sip.116.42 m², për vlerën 69.000 euro. Referuar të drejtave dhe detyrimeve të palëve të parashikuara në kontratë, e që në bazë të parashikimeve të K. Civil kanë vlerën e ligjit mes palëve kontraktuese, pagesa e plotë e çmimit do të kryhej në katër këste. Kështu, (i) kësti i parë, në shumën 15.000 euro, është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës, ***.9.2005; (ii) kësti i dytë, në shumën 6.000 euro, është rënë dakord të shlyhet në ***.10.2005; (iii) kësti i tretë, në shumën 46.000 euro, të shlyhej në datë ***.1.2006, dhe (iv) kësti i katërt, në shumën 2.000 euro, të shlyhej në momentin e dorëzimit të çelësave të apartamentit nga pala sipërmarrëse.

28.3 Referuar Kontratës së sipërmarrjes, datë ***.9.2005, si dhe deklarimeve të subjektit në DV-2005, subjekti deri në fund të vitit 2005 ka shlyer pjesërisht detyrimin për apartamentin, në shumën 21.000 euro, dhe në vitin 2006 ka paguar pjesën e mbetur, prej 48.000 euro. Për këtë

arsye, analiza financiare për çdo zë të ardhurash të deklaruar nga subjekti si burim krijimi për këtë aset, do të shtrihet në periudhën 2005 - 2006.

- 29. Për vitin 2005**, subjekti ka paguar 15.000 euro, në datën e nënshkrimit të kontratës, ***.9.2005,¹¹ dhe 6.000 euro, paguar në tetor 2005. Për krijimin e shumës 15.000 euro rezulton se kanë shërbyer si të ardhura: (i) 3.500 USD, kursime të mbartura nga viti 2004; (ii) hapje-mbyllje depozite, në shumën 50.000 lekë; (iii) 500.000 lekë, marrë hua tek të afërmit, pa afat dhe pa interes; (iv) kursimet e vitit 2005, në shumën 1.050.000 lekë.
- 29.1 (i) *Mbi kursimin në shumën 3.500 USD, të mbartura nga viti 2004*. Në D-Vett, subjekti deklaroi 3500 USD, kursime të mbartura nga viti 2004. Lidhur me shumën 3.500 USD¹², na rezultoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë si gjendje në bankë në DV-2004 dhe nuk është deklaruar as si kursim i mbartur në DV-2005. Në parashtrimet e tij, datë 21.7.2018, subjekti shpjegon lidhur me këtë mosdeklarim si vijon: “...në vitin 2004, kam deklaruar kursime në shumën 300.000 lekë, pa specifikuar vendndodhjen e tyre, pra nëse ishin në banesë apo në bankë. Kjo sasi prej 3.500 USD, e vendosur në sistemin bankar në vitin 2004, e ka burimin te kursimet e vitit 2004, të cilat kanë qenë të mjaftueshme për të justifikuar këtë shumë në bankë. ...pra shuma 3.500 USD në bankë, në fakt, është pikërisht kursimi prej 300.000 lekë dhe të tjera të deklaruara në vitin 2004”.
- 29.2 Sipas lëvizjeve të llogarisë, të vëna në dispozicion nga *** Bank, rezultoi se kjo shumë është depozituar nga subjekti në datë ***.11.2004 dhe tërhequr në datë ***.2.2005. Nga analiza financiare rezultoi që subjekti ka pasur mundësi kursimi në shumën 3.500 USD në vitin 2004.
- 29.3 (ii) *Mbi depozitën në vlerën 50.000 lekë*. Me shkresën nr.*** prot., datë ***.12.2017, Banka *** sh.a., konfirmon derdhjen cash në llogarinë e subjektit, të shumës 50.000 lekë, datë ***.9.2005, transaksion i kryer pas pagesës së këstit të parë të kontratës së sipërmarrjes dhe, rrjedhimisht, kjo shumë nuk mund të konsiderohet si pjesë e burimit të pasurisë.¹³
- 29.4 (iii) *Mbi huan nga të afërmit, në shumën 500.000 lekë*. Në deklaratën vjetore 2005, subjekti ka deklaruar huamarrje “500.000 lekë, marrë tek të afërmit e mi pa afat, pa interes”.
- 29.5 Në rubrikën “të dhëna që nuk publikohen” të deklaratës vjetore, ku duhen pasqyruar ndryshimet nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor, subjekti ka deklaruar “detyrime ndaj motrave e vëllezërve të mi dhe të bashkëshortes”.
- 29.6 Duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe qartësisht, Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me rrethin e personave huadhënës. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: “...këtë detyrim të krijuar e kam ndaj baxhanakut tim ***....”.
- 29.7 Për të provuar marrëdhënien e huas, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.1.2017, të shtetasit ***. Në këtë deklaratë, ky i fundit deklaroi se: “...në

¹¹ Sipas nenit 3 të kontratës së sipërmarrjes, datë ***.9.2005, subjekti ka arkëtuar shumën 15.000 euro, pranë shoqërisë “***” sh.p.k. Gjithashtu, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë ***.3.2018, subjekti deklaroi: “...me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes kam paguar pranë arkës së shoqërisë, shumën prej 15.000 euro”.

¹² Referuar korrespondencës zyrtare me “***” Bank, subjekti ka tërhequr 3.500 USD, në datë ***.2.2005, nga llogaria e tij.

¹³ Kësti i parë, prej 15.000 eurosh, është bërë në datë ***.9.2005.

periudhën nga vitit 2005 deri në vitin 2009 i kam dhënë disa herë hua subjektit për nevoja familjare, shuma parash baxhanakut tim, z. Besnik Cani...në total prej 1.000.000 lekësh¹⁴.

30. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, sa më sipër rezulton se subjekti nuk ka deklaruar datën dhe nuk qartëson mënyrën e marrjes së huave dhe as atë të shlyerjes së tyre, duke pamundësuar kontrollin financiar dhe ligjor të kësaj marrëdhënieje, përkundër detyrimin që ligji i njeh. Gjithashtu, nga përgjigjet e pyetësorëve të administruara në dosje, konstatohen deklarata kontradiktore lidhur me këto huamarrje, fakt që ngre dyshime mbi vërtetësinë e deklarimeve në to.
- 30.1 Po t'i referohemi jurisprudencës të Kolegjit në lidhje me situata të ngjashme në procesin e rivlerësimit të subjekteve të tjera, rezulton se Komisioni nuk ka zbatuar drejt kriteret e nenit 49/4, të ligjit nr. 84/2016, teksa u ka dhënë fuqi të plotë provuese deklaratave noteriale të sipërcituara dhe nuk ka arsyetuar bazueshmërinë e këtij qëndrimi, duke analizuar objektin e provueshmërisë së deklaratave noteriale në harmoni me prova dhe indicie të tjera të administruara.
- 30.2 Këto deklarata noteriale rezultojnë se datojnë pas dorëzimit të D-Vett, janë administruar gjatë hetimit administrativ dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbeten në nivelin deklarativ, nuk mund të konfirmojnë të vetme, dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur realisht¹⁵.
- 30.3 Nisur nga arsyetimi i vendimit, edhe pse nuk rezulton që Komisioni ta ketë kualifikuar ligjërisht z. ***.***, si person tjetër të lidhur¹⁶, në analizën financiare të tij, ka konsideruar si të ardhura të ligjshme huan e dhënë prej tij në vlerën 500.000 lekë. Për të provuar aftësinë huadhënëse të huadhënësit, burimin dhe realizimin e të ardhurave të ligjshme¹⁷, subjekti me shkresën nr. *** prot., datë ***.3.2018, lëshuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria Rajonale Durrës, ka vënë në dispozicion tabelat e llogaritjes së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për aktivitetin privat z.***.***, ku xhiroja vjetore e viteve 2005-2006 është mesatarisht në shumën 2.880.000 lekë.
- 30.4 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioneri Publik, edhe nëse e konsiderojmë këtë burim të mësipërm të deklaruar nga subjekti si burim të ligjshëm, rezulton se subjekti nuk ka të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer investimin për pagesën e kësaj përkatës të kontratës së sipërmarrjes për këtë apartament. Subjekti ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie (ref. tabelës nr.1).
31. (iv) Mbi kursimet në shumën 1.050.000 lekë, deklaruar si burim krijimi për asetin, rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare deri në datë ***.9.2005, kur është paguar kësti i parë i kontratës së sipërmarrjes, të kursejë shumën e deklaruar. Nga analiza financiare, paraqitur në formë tabelare si më poshtë, subjekti rezulton me një balancë negative prej **621.085** lekësh.

¹⁴Sipas deklaratës noteriale të të njëjtit shtetas, nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.3.2018, deklaron se në periudhën nga gusht 2017 - dhjetor 2017, subjekti i rivlerësimit e ka shlyer me këste shumën prej 1.000.000 lekësh.

¹⁵ Shihni Vendimin e Kolegjit nr.10, datë 19.11.2018, për subjektin e rivlerësimit ***.***.

¹⁶ Në kuptim të nenit 32, pika 4, të ligjit 84/2016.

¹⁷ Bazuar në kriteret e nenit 32, pika 4, të ligjit 84/2016, dhe nenit D/3 të aneksit të Kushtetutës.

Tabela nr.1- Analizë financiare për periudhën 1 janar – 1 shtator 2005

Likuiditete gjendje në llogari bankare, në fillim të viti	350.630 ¹⁸
Të ardhura SR janar - shtator 2005	710.026 ¹⁹
Të ardhurat e bashkëshortes, janar - shtator 2005	254.227 ²⁰
Hua nga të afërmit	500.000
Totali i likuiditeteve në dispozicion janar - shtator (1)	1.814.883
Total i shpenzimeve janar – shtator (2)	525.411
Paguar kësti i parë i apartamentit (3)	1.858.200
Likuiditete gjendje në llogari bankare, në fund të periudhës (4)	52.357²¹
Diferenca (1-2-3-4)	(621,085) lekë

- 31.1 Vlen të theksojmë se, në këtë analizë financiare, te zëri “shpenzime” nuk janë përfshirë shpenzime mobilimi, duke qenë se subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë **shpenzime mobilimi**, as në vitet 2005-2006, kur e ka blerë këtë apartament dhe as në vitet pasardhëse, kur e ka poseduar atë dhe kaluar në pronësi të plotë të tij. Nëse në analizën e mësipërme dhe ato të viteve vijuese do të përfshiheshin edhe shpenzime për mobilimin e këtij apartamenti, gjendja financiare e subjektit do të rezultonte me një diferencë negative më të madhe.
- 31.2 Subjektit i është kaluar barra e provës nga ana e Komisionit, mbi diferencën e konstatuar për këstin e parë paguar në datë ***.9.2005. Në parashtrimet e datës 21.7.2018, subjekti ka deklaruar se: “...diferenca është e justifikueshme me diferencat e standardit të jetesës mes qytetit dhe fshatit”. Ndërsa, në parashtrimet e tij përfundimtare, datë 20.11.2018, subjekti deklaroi se: “...diferencat negative të viteve 2005-2006, vijnë si pasojë e mosdeklarimit nga ana ime e gjendjeve cash në banesë”.
- 31.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e llogaritura për jetesën u referohen standardit të pranuar të ILDKPKI-së, që bazohen në burimet e INSTAT-it, të cilat, nga ana e tyre, u referohen shpenzimeve **minimale për jetesë**.²²
- 31.4 Pretendimi i subjektit se diferencat negative të viteve 2005-2006 vijnë si pasojë e mosdeklarimit nga ana e tij të gjendjeve cash në banesë, nuk qëndron, pasi në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve

¹⁸ Shuma 3.500 USD, e konvertuar me kursin e BSH-së, datë 1.9.2005.

¹⁹ Të ardhurat nga paga dhe shpërblime të subjektit për periudhën 1 janar deri në 1 shtator të vitit 2005, referuar vërtetimeve të pagave nga punëdhënësi, si dhe lëvizjeve të llogarive bankare.

²⁰ Të ardhurat nga paga dhe shpërblime të bashkëshortes së subjektit për periudhën 1 janar deri në 1 shtator të vitit 2005, referuar vërtetimeve të pagave nga punëdhënësi, si dhe lëvizjeve të llogarive bankare.

²¹ Gjendja në llogarinë bankare të SR, në datë ***.9.2005.

²² Sipas materialit të INSTAT-it, lidhur me rezultatet e Anketës së buxhetit të familjes në Shqipëri,²² për vitet 2006-2007, shpenzimet mesatare vjetore të një familjeje të përbërë nga 4 persona, janë në vlerën 816.000 lekë në vit. Shuma e llogaritur si shpenzime minimale jetike në vlerën 642.860 lekë, është ndjeshëm më e ulët se vlera sipas anketimit të INSTAT-it 2006-2007.

financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ka pasur detyrimin të deklarojë saktësisht gjendjen *cash* në fund të periudhës së deklarimit.

- 31.5 Referuar parashtrimeve të datës 20.11.2018, nëse do të ishte i vërtetë pretendimi i subjektit, rezulton se ai ka kryer fshehje të pasurisë gjatë deklarimeve ndër vitet përkatëse.
- 31.6 **Në vitin 2005.** Në DV-2005, subjekti ka deklaruar një hua nga baxhanaku, z. ***.***. Me vendbanim në Greqi, për një shumë 6.000 euro.
- 31.7 Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka konsideruar baxhanakun e subjektit, z. ***.***, si person tjetër të lidhur dhe ka hetuar lidhur me të ardhurat e realizuara prej tij. Nga nxjerrja e llogarisë bashkëlidhur shkresës nr. ***, datë ***.12.2017, të *** Bank, konstatohet një transfertë në mbërritje, në shumën 5.990 euro, datë ***.10.2005, dhe tërheqja e po kësaj shume, në datë ***.10.2005.
- 31.8 Për të provuar aftësinë huadhënëse të baxhanakut të tij, subjekti i ka paraqitur Komisionit si provë shkresore dokumentacion nga organet tatimore greke, që vërteton të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, në periudhën 2004-2006, shoqëruar me vulë apostile. Gjithashtu, lidhur me këtë transaksion, subjekti ka vënë në dispozicion dhe nxjerrje të llogarisë bankare të shtetasit z. ***.***, nga *** Bank Greece, ku konfirmohet transfertat e kryer në datë ***.10.2005, në shumën 6.011.74 euro, dhe, në të njëjtën kohë, kreditohet llogaria e subjektit në datë ***.10.2005. Kjo shumë e marrë hua, korrespondon me pagesën e kësaj të detyrës sipas modaliteteve të pagesës në kontratën e sipërmarrjes, sipas së cilës parashikohet pagesa e shumë prej 6.000 eurosh, brenda datës ***.10.2005.
- 31.9 **Në vitin 2006.** Në DV-2006, subjekti ka deklaruar se ka likuiduar detyrimin ndaj firmës “***” sh.p.k., në vlerën 48.000 euro. Në po këtë vit. ai ka deklaruar kredi për shtëpi banimi nga *** Bank. në shumën 40.000 euro, datë ***.1.2006, dhe hua nga të afërmit, pa interes, në shumën 350.000 lekë.
- 31.10 Lidhur me huan e deklaruar, në vlerën 350.000 lekë, rezulton se subjekti në të njëjtën deklaratë vjetore, në faqen nr. 8, ka deklaruar baxhanakun, z. ***.***, si subjekt huadhënës. Subjekti nuk ka specifikuar datën e huamarrjes dhe mënyrën e huamarrjes (*cash* apo rrugë bankare).
- 31.11 Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, i pyetur nga Komisioni mbi huadhënësin dhe mënyrën e pagesës/arkëtimit të huas, subjekti deklaron të tjera rrethana për këtë fakt, duke parashtruar se këtë hua e ka marrë nga baxhanaku, z. ***.***. Kontradiktat e subjektit në deklarimin e huadhënësit dhe justifikimin e huave me deklaratën noteriale të depozituar si provë pranë Komisionit, gjatë plotësimit të dokumentacionit në datën ***.1.2017, për të plotësuar dosjen për procesin e rivlerësimit, ngrenë dyshime mbi vërtetësinë e këtyre deklaratave dhe ligjshmërisë së burimit të deklaruar, për aq kohë sa subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumentacion kryerjen e transaksioneve të huadhënies apo shlyerjen e tyre²³.
- 31.12 Referuar modaliteteve të pagesës sipas kontratës së sipërmarrjes, subjekti ka rënë dakord të paguajë këstin prej 46.000 eurosh në datë ***.1.2006, nga të cilat 40.000 euro kredi nga *** Bank, konfirmuar nga kjo e fundit me shkresën nr. ***, datë ***.12.2017, disbursuar në llogarinë bankare të tij më datë ***.1.2006.

²³ Shihni, gjithashtu, Vendimin e Kolegjit nr.10, datë 19.11.2018, për subjektin e rivlerësimit ***.***.

- 31.13 Diferenca prej 6.000 eurosh, mbetur për t'u paguar deri në datë ***.1.2006, nuk mbulohet me të ardhurat e ligjshme të subjektit, të cilat deri në këtë moment rezultojnë të jenë në shumën rreth 58.000 lekë në total, referuar lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes.
- 31.14 Nga analiza financiare e vitit 2006 (ref. tabelës nr. 2), edhe nëse konsiderohet si e ardhur e ligjshme, huaja e deklaruar në këtë vit për pagesën e detyrimeve ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., deri në fund të vitit 2006, rezulton se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet, kursimet dhe pagesën e kryer në favor të shoqërisë në fjalë.

Tabela nr. 2 - Analizë financiare për vitin 2006

Likuiditete gjendje në llogari bankare në fillim të periudhës	(67.381)
Të ardhurat nga pagat SR dhe bashkëshortja gjatë vitit 2006	1.566.243
Borxh nga të afërmit	350.000
Hua bankare	4.954.000
Totali i likuiditeteve në dispozicion (1)	6.802.861
Shpenzimet (2)	1.161.094
Shpenzime minimale jetese	642.860
Shpenzime udhëtimi	61.925
Shpenzime kredie	456.309
Paguar kësti i apartamentit (3)	5.944.800
Likuiditete gjendje në llogari bankare, në fund të periudhës (4)	(176.032)
Diferenca në mbulimin e të ardhurave	(127.000) lekë

32. Ndryshe nga përfundimi që ka arritur Komisioni në arsyetimin e vendimit të tij, se “...këto pasaktësi dhe këto **mangësi të burimeve financiare** - për një total të akumuluar në pesë vjet (dhe të shpërndara në harkun kohor 11-vjeçar), në shumën prej 819.812 lekësh²⁴ - nuk janë të mjaftueshme që të pasjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi, sigurisht, që duhet të kryhet nëpërmjet një analizë kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit”, Komisioneri Publik çmon se provat e paraqitura nga subjekti nuk provojnë burimin e ligjshëm dhe realizimin e të ardhurave të ligjshme për krijimin e këtij aseti, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.
33. Vlerësojmë se, në rastin konkret, referenca e Komisionit të parimi i “proporcionalitetit” për të justifikuar moszbatimin e nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016, në argumentimin e vendimit për pasurinë 1, sikundër dhe në pjesë të tjera të vendimit²⁵, është bazuar në një interpretim të gabuar të normativës kushtetuese dhe ligjore.
- 33.1 Parimi i proporcionalitetit, si një nga parimet “klasike”, që ka gjetur vlerësim të vazhdueshëm në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, është trajtuar gjerësisht lidhur me të drejtat e njeriut, mbrojtja e të cilave përbëjnë dhe bazën në një shoqëri demokratike. Për të

²⁴ Me bilancin më negativ ndër këto 5 vjet, që arrin në minus 258.978 lekë, në vitin 2005.

²⁵ Për bilancin negativ në analizën financiare, etikën profesionale (marrëdhënia civile me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe përfitimit të statusit të familjes së pastrehë).

kuptuar më mirë këtë parim, pyetja vendimtare është: si kufizohet “thelbi” (i së drejtës) dhe se si mjetet përcaktuese ndërveprojnë me elementet e tjera të qenësishme në vlerësimin e proporcionalitetit²⁶. Pra, një kufizim do të cenonte “thelbin”, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjetit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet.

- 33.2 Lidhur me këtë parim, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 40, datë 7.7.2014, ka theksuar se [... *Proporcionalitetin e një kufizimi, ajo e vlerëson rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes së drejtës/garancisë së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën/garancinë e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori.*]
- 33.3 Në këtë kontekst, nuk duhet të përjashtojmë natyrën e procesit të rivlerësimit, kushtetutshmërinë e tij në respektimin e parimeve mbrojtëse e garantuese për subjektet që i nënshtrohen, dhe sjellim në vëmendje vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka mbajtur qëndrimin se: [“67. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6, të KEDNJ-së] ... [Për rrjedhojë, për shkak të garancive që ofrojnë këto organe, vlerësohet se subjekteve të rivlerësimit u garantohet e drejta e ankimit në një shkallë më të lartë gjykimi, sipas nenit 43 të Kushtetutës, e cila ka të drejtë të gjykojë në themel çështjen dhe të vendosë përfundimisht në lidhje me të”].
- 33.4 Ndërkohë, ligjvënësi, në nenin 4, të ligjit nr. 84/2016, ka përcaktuar se Komisioni dhe Kolegji ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
- 33.5 Nga leximi i kësaj dispozite, në vështrim sa parashtruar dhe më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se qëllimi i parashikimit të parimeve që udhëheqin veprimtarinë e dy institucioneve rivlerësuese, pra Komisioni dhe Kolegji, është në funksion të garantimit të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, dhe parimi i proporcionalitetit në këtë rast nuk mund të merret i shkëputur më vete e të gjejë zbatim rast pas rasti, në raport me shkallën apo zbatimin e masës disiplinore, që gjen zbatim si rezultat i procesit të rivlerësimit.
- 33.6 Rëndësinë e procesit të rivlerësimit në raport me të drejtat e subjektit, e reflekton më së miri neni A i aneksit të Kushtetutës, dispozitë e cila ka përcaktuar se, për qëllim të kryerjes së procesit të rivlerësimit, kufizohen pjesërisht respektimi i disa të drejtave sipas nenit 17 të Kushtetutës.

²⁶ Shihni ndër të tjera – GJEDNJ, “Tinnelly & Sons Ltd dhe të tjerët dhe McElduff dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar”, 10 korrik 1998.

33.7 Sa më sipër, është vetë Kushtetuta dhe ligji, të cilat kanë parashikuar si garancitë e nevojshme ndaj subjekteve që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit,²⁷ ashtu dhe kufizimet përkatëse. Si rrjedhojë, masat e marra nga organet e rivlerësimit gjatë veprimtarisë së këtij juridiksioni të posaçëm, e për më tepër në rastet kur konstatohen jo vetëm një, por disa problematika mbi kriteret e rivlerësimit, parimi i proporcionalitetit nuk mund të shërbejë si strehë për anashkalimin e vetë qëllimit për të cilin është ngritur procesi i rivlerësimit dhe zbatimit korrekt të ligjit të posaçëm (neni 61/5).

34. Pasuria nr. 2 - Në D-Vett. deklarohet: “Truall”, me sipërfaqe 633.8 m², dhe një banesë private me sip. 112 m², pasuria me nr.*** z. k. ***, me vendndodhje ***, Tiranë. Pasuria është fituar me legalizim nga ALUIZNI,²⁸ në vitin 2008, me vlerë 721.400 lekë (parcelë ndërtimore), 30.732 lekë (taksë ndikimi në infrastrukturë), 100% në pronësi të subjektit. Si burim i krijimit të pasurisë deklarohet: (i) kursime nga të ardhurat personale dhe të bashkëshortes, (ii) detyrimet familjare etj.

Në Dv -2003. deklarohet: “Banesë private”, me sipërfaqe 100 m², komuna ***, e ndërtuar që nga viti 1995, me kosto ndërtimi 700.000 lekë. Si burim krijimi deklarohen: (i) kursime familjare dhe (ii) kursimet nga emigracioni 1993-1994.

34.1 Në dosjen e Komisionit është administruar:

- shkresë e ALUIZNI-t, nr.*** prot., datë ***.1.2018, bashkëlidhur praktika e legalizimit;
- leje legalizimi nr.***, datë ***.7.2002, për godinë banimi 1 kat;
- shkresë e ZVRPP-së Tiranë, nr.*** prot., datë ***.3.2018, bashkëlidhur dokumentacionin e origjinës për pasurinë nr.*** dhe nr.***;
- deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2018, e shtetasit ***. ***²⁹ (babai i subjektit);
- deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2018, e shtetasit ***.***;
- deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2018, e shtetasit ***.*** (kunati i subjektit);
- deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2018, e shtetasit ***.*** (motra e subjektit).

34.2 Gjatë hetimit administrativ, nga gjendja e akteve në dosje, Komisionit i ka rezultuar: (i) mospërputhje midis sipërfaqes e tokës dhe të ndërtesës, të vetëdeklaruar për legalizim nga subjekti dhe të sipërfaqeve faktike të legalizuara; (ii) paqartësi në kohë e periudhës së ndërtimit të shtëpisë; (iii) mungesë dokumentacioni ligjor lidhur me burimin e krijimit të pasurisë dhe mënyrën e ndërtimit.

34.3 Lidhur me këto fakte, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës³⁰ për të paraqitur shpjegime dhe prova, për të provuar të kundërtën dhe, pasi ka administruar përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni në vendimin e tij arsyeton se: “...subjekti i rivlerësimit ka kryer

²⁷ Shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036, të Komisionit të Venecias.

²⁸ Kontratë e kalimit të parcelës ndërtimore nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.6.2009.

²⁹ Në të gjitha deklaratat, deklaruesit pohojnë që kanë kontribuar në ndërtimin e banesës me punë vullnetare (argat).

³⁰ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

*deklarime të pasakta në lidhje me sipërfaqet e banesës dhe të terrenit në ***, si dhe ka munguar të deklarojë posedimin e terrenit në vitet para legalizimit; ...gjithsesi shpjegimet dhe dokumentacionet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit konsiderohen deri diku bindëse për sa u përket pasaktësive. Por nga këndvështrimi juridiko - ligjor – edhe pse mund të konsiderohet si një fakt historik real informaliteti në Shqipëri asokohe – subjekti, përtej shpjegimeve, nuk ka dhënë asnjë provë konkrete lidhur me shpenzimet e kryera për ndërtimin e banesës në *** dhe të burimit të tyre”.*

35. Komisioneri Publik vlerëson të ripërsërisë se dhe për këtë çështje, po t'i referohemi jurisprudencës të Kolegjit në lidhje me situata të ngjashme në procesin e rivlerësimit të subjekteve të tjera, rezulton se Komisioni nuk ka zbatuar drejt kriteret e nenit 49/4, të ligjit nr. 84/2016, teksa u ka dhënë fuqi të plotë provuese deklaratave noteriale të sipërcituara dhe nuk ka arsyetuar bazueshmërinë e këtij qëndrimi, duke analizuar objektin e provueshmërisë së deklaratave noteriale në harmoni me prova dhe indicie të tjera të administruara.

35.1 Risjellim në vëmendje se këto deklarata noteriale rezultojnë se datojnë pas dorëzimit të D-Vett., janë administruar gjatë hetimit administrativ, dhe, si të tilla, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti, mbeten në nivelin deklarativ, nuk mund të konfirmojnë të vetme, dhe jo në harmoni me prova të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur realisht³¹.

35.2 Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimi i arritur nga Komisioni, se “...vlerësimi i veprimeve juridike dhe deklaratave që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në lidhje me këtë pasuri, edhe pse nuk rezulton i provuar çdo pretendim i tij, në vetvete dhe të vetme këto pasaktësi apo veprime ose mosveprime, nuk mund të pasjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi kjo do të binte ndesh me parimin e proporcionalitetit”, vlerëson se ka vend për zbatimin e nenit 61/3, lidhur me nenin 61/5, të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm të subjektit.

36. Pasuria nr. 3 - Në D-Vett., subjekti ka deklaruar: Autoveturë “Mercedez-Benz”, tip B180, viti prodhimit 2006, blerë me kontratë shitblerje nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.1.2012, për vlerën 1.300.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, 50% secili. Si burim i krijimit të pasurisë deklarohet: të ardhurat familjare.

Në DV-2012 deklarohet: Blerje autoveture, më datë ***.1.2012, me vlerë 1.300.000 lekë, ku pjesa takuese e subjektit është 50%, pa deklaruar burimin e krijimit.

37. Pasuria nr. 4 - Në D-Vett., subjekti ka deklaruar: “Garazh” me nr. pasurie ***, datë***.4.2012, z. k. ***, sip 18.7 m², në pallatin e shoqërisë “****” sh.p.k., rr. “****” Tiranë, blerë me kontratën nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.4.2012, për vlerën 7.000 euro. Si burim i krijimit të pasurisë deklarohet: të ardhurat familjare.

Në DV-2012 deklarohet: Blerje garazhi, me sip.18.76m², datë ***.4.2012, me vlerë 7.000 euro, 100% në pronësinë e subjektit. Nuk deklarohet burimi i krijimit për këtë pasuri.

³¹ Shihni Vendimin e Kolegjit nr.10, datë 19.11.2018, për subjektin e rivlerësimit ***,***.

38. Analizë financiare e shpenzimeve të subjektit, vitet 2010-2015

Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit, për periudhën deri në vitin 2015, përveç sa trajtuar më sipër, lidhur me blerjen e pasurisë nr.1, rezultoi se subjekti nuk mbuloi me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe investimet gjatë viteve 2010-2015, për një diferencë totale negative prej - 2.152.963 lekësh, paraqitur në formë tabelare, si vijon:

Analizë financiare 2010-2015, në lekë						
Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015
1 Likuiditet në fillim të vitit	-61.353	-45.907	1.417.013	1.184.520	1.914.436	2.608.980
2 Të ardhurat	2.203.766	3.110.322	3.262.136	2.814.368	2.965.217	2.838.586
3 Huamarrja	200.000	-	-	-	900.000	-
4 Shpenzimet	2.865.437	2.414.605	1.734.708	2.329.335	3.271.399	2.008.926
5 Pasuritë	-	-	2.277.130 ³²	-	-	-
6 Likuiditet në fund të vitit	-45.907	1.417.013	1.184.520	1.914.436	2.608.980	3.484.464
Diferenca (1+2+3-4-5-6) = -2.152.963	-477.118	-767.203	-517.209	-244.884	-100.726	-45.825

39. Metodologjia e përdorur në analizën financiare

- 39.1 Të ardhurat përfshijnë: (i) të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes nga pagat, shpërblimet, dhe honoraret të marra nga nxjerrjet e llogarive bankare³³; (ii) të ardhurat nga qiraja sipas deklarimeve të subjektit dhe verifikuar me dokumentacionin tatimor; (iii) të ardhura nga shitje automjeti,³⁴ (iv) të ardhura nga bonusi i karburantit³⁵; (v) interesat e përfutur nga investimet në fondet e pensionit dhe investimet³⁶; (vi) të ardhurat si stimul për rezultate të shkëlqyera në favor të ***.***; (vii) rimbursim nga kolegji shqiptaro-grek “****”.
- 39.2 Shpenzimet përfshijnë: (i) shpenzimet minimale të jetesës sipas ILDKPKI-së, bazuar në të dhënat statistikore të INSTAT-it; (ii) shpenzime për shlyerjet e kredive në *** Bank dhe *** Bank, ku përfshihen edhe shpenzimet që lidhen me siguracionet e kredive dhe shlyerjet e parakohshme, sipas nxjerrjeve të llogarive bankare; (iii) shpenzime spitalore sipas deklaratës së subjektit në pyetësorin nr. 2. Lidhur me këto shpenzime, nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet sipas deklaratave noteriale,³⁷ të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi mbulimin

³² Automjet dhe garazh.

³³ *** Bank, shkresë nr.*** prot., datë ***.12.2017.

*** Bank, shkresë nr.*** prot., datë ***.12.2017.

*** Bank, shkresë nr.*** prot., datë ***.12.2017.

*** Bank, shkresë nr.*** prot., datë ***.12.2017.

Nuk janë përfshirë të ardhurat e paguara nga institucionet në formë diete, pasi koncepti “dieta” nënkupton përdorimin e këtyre fondeve për mbulimin e një shpenzimi.

³⁴ Kontratë shitblerje nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.1.2012.

³⁵ Janë llogaritur ditët kur subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në Këshillin e Prokurorisë, ditët e lejes vjetore dhe ditët e qëndrimit jashtë dhe totali i tyre është shumëzuar me bonusin ditor, prej 1591 lekë/ditë. Kjo shumë është përfshirë në kategorinë e të ardhurave të subjektit, pasi, sipas pretendimeve të tij, ai e ka kursyer këtë fond. Nuk është marrë në konsideratë pretendimi i subjektit mbi ndarjen e shpenzimeve me kolegjin.

³⁶ Sipas shkresës së *** Invest nr.*** prot., datë ***.12.2017.

³⁷ Deklaratë noteriale nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018; nr.*** rep. *** kol., datë ***.7.2018;

e shpenzimeve nga miq dhe të afërm, pasi sikundër është parashtruar në vijimësi më lart në këtë ankim, deklaratat që datojnë pas D-Vett., nuk kanë fuqi provuese, që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur realisht, në qoftë se nuk vijnë në harmoni me prova të tjera dhe më së paku deklaramet ndër vite të subjektit, në rastin konkret³⁸; (iv) shpenzimet për shkollimin e fëmijëve³⁹; (v) shpenzimet për shlyerjet e detyrimeve/huave kundrejt familjarëve sipas deklaratave të subjektit; (vi) shpenzimet e udhëtimit, që janë përlllogaritur nga të dhënat e sistemit TIMS, për subjektin e rivlerësimit dhe familjarët e tij⁴⁰.

39.3 Gjatë vitit 2012 rezulton se subjekti ka kryer investimet për blerje automjeti dhe garazh, të cilat janë përfshirë në shpenzimet e këtij viti. Lidhur me këto investime rezulton se: (i) me kontratë shitblerje nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.1.2012, ka blerë autoveturë, “Mercedes-Benz”, tip B180, viti prodhimit 2006, për vlerën 1.300.000 lekë (cash); (ii) me kontratën e shitblerjes nr.*** rep. *** kol., datë ***.4.2012, ka blerë garazh, me sip.18.76 m,² për vlerën 7.000 euro.

III. B Vlerësimi i aftësive profesionale

40. Kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në nivel kushtetues e gjejmë të rregulluar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës, dhe për subjektet që ushtrojnë funksionin e prokurorit përfshihet aftësia për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësia organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale. Ndërkohë, në nivel ligjor, referuar nenit 40, të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale fokusohet në dy elemente, (i) vlerësimi i veprimtarisë etike të subjektit dhe (ii) ajo profesionale, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht ligji nr. 96/2016.
41. Nga leximi literal i këtij kuadri normativ, kuptojmë se institucionet e rivlerësimit, dhe në këtë rast, Komisioni, në referencë të rolit që i njeh neni 179/b, pika 5, e Kushtetutës, duhet të kujdeset dhe sigurojë që vlerësimin e këtij kriteri (sikurse dhe dy të tjerat), për qëllim të arritjes së objektivit që vendos vetë ky nen, në pikën 1 të tij, ta kryejë ai vetë (Komisioni), si organ i pajisur me kompetencat e nevojshme, bazuar në parashikimet e aneksit kushtetues, ligjit të posaçëm dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
42. Lidhur me këto kompetenca të Komisionit, brenda të cilave ky organ kushtetuese është i autorizuar të veprojë në kontrollin e kriterëve të rivlerësimit, mes të cilave dhe atij të aftësive profesionale, sjellim në vëmendje dhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, ku shprehet se: *[22. I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me*

³⁸ Shihni vendimin e KPA-së nr.10, datë 19.11.2018, për subjektin e rivlerësimit *** ***.

³⁹ Vërtetim kolegjit “***” nr.*** prot., datë ***.3.2018, dhe nr.*** prot., datë ***.3.2018. Vërtetim Instituti *** *** nr.*** prot., datë ***.3.2018. Vërtetim Kolegji Greko-Shqiptar ***, nr.*** prot., datë ***.3.2018.

⁴⁰ Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet për udhëtimet e punës të vërtetuar me shkresë nga institucionet përkatëse. Për udhëtimet personale është llogaritur kostoja minimale prej 50 euro nata për ushqim dhe akomodim, për të rritur dhe ½ e kësaj shume për fëmijë, dhe 50 euro shpenzim udhëtimi, kur udhëtimi ka qenë me makinë (sipas deklarimeve të subjektit dhe evidencave nga sistemi TIMS). Në rastet kur udhëtimi ka qenë me linja ajrore, janë llogaritur kosto udhëtimi që variojnë nga 180 euro për linjat ekonomike deri në 300 euro për udhëtimet e largëta. Për udhëtimet që janë vajtje-ardhje brenda ditës, është llogaritur vetëm një kosto minimale 30-50 euro, për karburant, në varësi të kohëzgjatjes së qëndrimit jashtë kufirit sipas të dhënave të TIMS. Ndërsa lidhur me udhëtimet që subjekti ka deklaruar në pyetësor, që ka udhëtuar me familjen drejt *** , për pushime bashkë me kumatën, janë llogaritur vetëm biletat e tragetit për numrin e hyrje-daljeve, si dhe një kosto qëndrimi 10 euro në ditë për fëmijët dhe 20 euro në ditë për të rritur. Për periudhën 2010 -2015, nga të dhënat e TIMS rezulton që subjekti të këtë bërë mesatarisht në një vit 10-20 udhëtime personale jashtë vendit, vetëm ose me familjen.

karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato.]

43. Në vështrim të sa më sipër, rezulton se nga hetimi administrativ i Komisionit janë konstatuar mangësi në etikën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit, të tilla që për nga karakteri dhe përsëritja, bazuar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, e kanë detyruar Komisionin t'i kalojë subjektit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
44. Me gjithë problematikat e konstatuara, Komisioni, në referencë të arsyetimit të vendimit, ka vlerësuar se subjekti arrin një nivel minimal kualifikimi dhe duhet të konfirmohet në detyrë. Në të njëjtën kohë, Komisioni ka vendosur që disa nga çështjet ku evidentohen mangësitë të lidhura me etikën dhe profesionalizmin e subjektit, t'ia transferojë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore. Çështjet e transferuara janë si vijon:
- a. Praktika e marrëdhënies juridiko-civile ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k.;
 - b. Çështja me nr.***, të vitit 2006, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
 - c. Dosja e procedimit penal me nr. ***, të vitit 2012, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të pastrehë, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr. 14, datë 28.3.2013;
 - d. Çështja me nr. ***, të vitit 2015, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
45. Komisioneri Publik, në analizë të gjetjeve të vetë Komisionit mbi çështjet e mësipërme, vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e mosarritjes së nivelit minimal kualifikues, referuar etikës dhe aftësive profesionale të tij. Si rrjedhojë, në konsideratë të qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, kërkesave të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 59, 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, dhe për aq sa gjen zbatim ligji nr. 96/2016, mangësitë e konstatuara sjellin një përfundim të ndryshëm në lidhje me konfirmimin në detyrë të subjektit.
- (i) Lidhur me etikën**
46. Çështja “a” - “Marrëdhënia juridiko-civile, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k.”
- 46.1 Kjo marrëdhënie civile konstatohet se është formalizuar me kontratën noteriale të datës ***.1.2016, lidhur mes subjektit, kunatit të tij, z. ***.***, të dy në cilësinë e palës qiradhënëse dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit.
- 46.2 Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e dy pasurive, e llojit truall, si dhe dy godinave të ngritura mbi këto troje, shoqërisë “****” sh.p.k., me qëllim që kjo e fundit të ushtrojë aktivitet tregtar për shitjen me pakicë të karburantit dhe aktivitete tregtare ndihmëse, pasi qiramarrësi të ketë ndërtuar me shpenzimet e veta një stacion të tregtimit me pakicë të karburanteve, lokal dhe lavazh. Nënvizojmë se pasuritë që subjekti pretendohet se ka dhënë me qira, bazuar në këtë

kontratë, janë ato të përshkruara më lart në këtë ankim, kur është trajtuar pasuria nr. 2, e deklaruar prej tij (banesë + truall në ***, Tiranë).

46.3 Referuar nenit 3 të kësaj kontrate, vlera e qirasë dhe modalitetet e pagesës së saj janë:

- i. Qiradhënësi (subjekti) gjatë afatit 25-vjeçar do të përfitojë qira mujore në shumën 5 lekë/bruto për çdo litër karburant të shitur në atë muaj, në stacionin e karburantit. Pagesa e qirasë do të përllogaritet duke nisur nga data që qiramarrësi do të fillojë aktivitetin e shitjes së karburanteve.
- ii. Pagesa e qirasë do të bëhet pasi shoqëria “****” sh.p.k. (qiramarrësi) të zbresë nga vlera totale, tatimin në burim sipas legjislacionit tatimor në fuqi, detyrim që i njihet qiradhënësit, si dhe 50% të fitimit neto mbi shumën mujore, që do të shërbejë për shlyerjen e investimit të kryer nga shoqëria “****” sh.p.k., për ndërtimin e stacionit të tregtimit të karburantit, lokalit dhe lavazhit.

46.4 Në nenin 4 të kontratës përcaktohet se palës qiradhënëse, në përfundim të shlyerjes së investimit të kryer nga qiramarrësi, shoqëria “****” sh.p.k. i kalon pronësinë e stacionit të tregtimit me pakicë të karburanteve, së bashku me lokalin dhe lavazhin e ndërtuar.

46.5 Rezulton se në këtë kontratë janë kryer disa ndryshime thelbësore, që prej nënshkrimit të saj. Ndryshimi i parë kryhet më datë ***.1.2017, ku tashmë si qiradhënësi i vetëm figuron subjekti i rivlerësimit, pasi bleu (më 25 tetor 2016) pjesën takuese të truallit prej 363.70 m,² të ***.***, duke u bërë kështu pronar i vetëm i truallit prej 997.50 m².

46.6 Ndryshimi i dytë në këtë kontratë kryhet më datë ***.4.2017, ku qiramarrësi, shoqëria “****” sh.p.k. heq dorë nga e drejta e përdorimit dhe e fitimit nga lavazhi dhe lokali bar-kafe (ndërtime të reja, të kryera me shpenzimet e shoqërisë mbi truallin e subjektit), duke ia kaluar këtë të drejtë subjektit të rivlerësimit, qiradhënësit.

46.7 Po në të njëjtën datë, me Aktmarrëveshjen nr.*** rep., nr.*** kol., subjekti i rivlerësimit ia kalon të drejtën e përdorimit për ambientet lavazh dhe lokal bar-bufe, djalit të tij z. ***.***⁴¹. Ky i fundit, me anë të prokurës nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.6.2017, ia delegon të drejtën e përfaqësimit të administrimit të këtij aktiviteti tregtar (lavazh dhe lokal bar-bufe), nënës së tij znj.***.***.

46.8 Komisioni, pasi ka administruar përgjigjet dhe provat e subjektit të rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e barrës së provës që i kishte kaluar për këtë çështje, arsyeton se: “..termi “kontratë qiraje” është i papërshtatshëm dhe jo koherent me përmbajtjen dhe me efektet që prodhon kontrata në fjalë... Ky konkluzion arrihet jo vetëm për faktin...se kontrata është hartuar nga departamenti juridik i shoqërisë “****” sh.p.k., ...por kryesisht për rrethanën e provuar nëpërmjet një sërë kontratash, kontrata qiraje të lidhura nga shoqëri të ndryshme me të tretë, ku “pagesa e qirasë bëhet me lekë për litër”. Sa më lart, e përjashton hipotezën se subjekti i rivlerësimit mund të ketë lidhur një kontratë të emëruar “qiraje”, me qëllim që të fshehte efektet reale të saj - edhe pse të ndryshme nga ato që prodhon një kontratë e mirëfilltë qiraje”.

⁴¹ Me shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nr.*** prot., datë ***.4.2018, ***.*** është regjistruar si person fizik më datë ***.3.2017, me NIPT-***.

47. Në vlerësimin e Komisionierit Publik, qëndrimi i Komisionit është kontradiktor dhe jo bindës, nisur nga krahasimi i marrëdhënies kontraktuale me subjektin nga njëra anë dhe ato të shoqërisë “****” sh.p.k., me subjektet e tjera, referuar kontratave të ngjashme të administruara në cilësinë e provës.

47.1 Konstatohet se elementet kontraktuale në secilën prej tyre (kontratave) paraqiten të ndryshme në efektet ligjore që passjellin. Në analizë të përmbajtjes së këtyre kontratave, konstatohet se ato janë kontrata tipike qiraje në kuptim të nenit 801 të Kodit Civil⁴² dhe vetëm kontrata e datës ***.3.2017 është një kontratë e ngjashme me kontratën që shoqëria “****” sh.p.k. ka lidhur me subjektin.

47.2 Megjithatë, edhe në këtë rast, kontrata e ofruar për referencë ka ndryshime të qenësishme lidhur me: (i) investimin, i cili, sipas kontratës me subjektin, i mbetet këtij të fundit, ndërsa në kontratën e ngjashme, investimi i mbetet shoqërisë “****” sh.p.k.; (ii) në fund të kohëzgjatjes së kontratës me subjektin e rivlerësimit, subjekti do të bëhet pronar mbi objektet e ndërtuara në tokën e tij, ndërkohë që ky fakt nuk parashikohet në kontratën e ofruar për referencë.

47.3 Nisur nga këto elemente, që janë pjesë vetëm e kontratës që subjekti ka lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., rezulton se kjo marrëdhënie juridiko-civile është me natyrë preferenciale. Në këtë arsyetim ligjor dhe faktik, nuk mund të mos merret në konsideratë shprehja e vullnetit të shoqërisë qiramarrëse, kur vetëm dy muaj pas fillimit të pagesës së qirasë⁴³ (në datë***.4.2017) ka hequr dorë nga e drejta e përdorimit me afat 25-vjeçar dhe marrjes së fitimit financiar të lavazhit dhe lokalit bar-kafe (ndërtuar me investimin e shoqërisë), pa asnjë kompensim financiar nga ana e subjektit.

47.4 Komisioneri Publik, referuar nenit 681⁴⁴ dhe 801, të Kodit Civil, vlerëson që kontrata e subjektit të rivlerësimit, edhe pse *de jure* është emërtuar si “kontratë qiraje”, *de facto* ajo konsiston në një marrëdhënie tregtare, ku subjekti është pjesëmarrës në fitimin e shoqërisë për atë pjesë të kapitalit sipas përcaktimeve në kontratë.

47.5 Elementet kontraktuale që të çojnë në këtë përfundim, janë elementet si vijon:

(i) Pagesa e qirasë nuk është një tarifë fikse qiraje, por përbëhet nga një shumë monetare, që varion në bazë të ecurisë së biznesit, dhe subjekti dukshëm merr përsipër riskun që qiraja të reduktohet edhe në vlerën zero, në rast falimentimi. Kjo e dallon qartë nga elementet e qirasë që parashikon KC, ku neni 801 kërkon “një shpërblim të caktuar”.

(ii) Subjekti kontribuon në natyrë, duke i ofruar shoqërisë “****” sh.p.k. një parcelë toke në këmbim të marrjes së një përqindje të qarkullimit monetar, që realizohet nga shitja e karburantit. (iii) Me parashikimin e nenit 3.2 në kontratë, ku subjekti merr 5 lekë/bruto për çdo litër karburant të shitur

⁴² Qiraja është kontrata me të cilën njëra palë (qiradhënësi) detyrohet t’i japë palës tjetër (qiramarrësit) një send të caktuar, në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi të caktuar.

⁴³ Sipas kushtit kontraktor. “Pagesa e qirasë do të përlllogaritet duke nisur nga data që qiramarrësi do të fillojë aktivitetin e shitjes së karburanteve”, fakt ky i ndodhur në shkurt 2017.

⁴⁴ Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës.

në atë muaj, në stacionin e karburantit, nënkupton që palët ndajnë fitimin e aktivitetit tregtar. Për më tepër, shoqëria “****” sh.p.k. do të paguajë të gjitha taksat që duhet t’i paguajë subjekti i rivlerësimit nga “qiraja mujore”.

(iv) Përcaktimi në kontratë se 50% e fitimit neto mbi shumën mujore do të shërbejë për kompensimin e investitorit, shoqërisë “****” sh.p.k., për ndërtimin e stacionit të tregtimit të karburantit, lokalit dhe lavazhit, është një tregues më tepër që subjekti i rivlerësimit po investon dhe kontribuon në krijimin e objekteve të veprimtarisë tregtare.

47.6 Nga analizimi i të ardhurave nga (i) vlera e qirasë dhe nga (ii) aktiviteti ekonomik (lavazh/bar - kafe), administruar nga djali i subjektit, z. ***.***, rezulton se të ardhurat e përfituara nga qiraja me shoqërinë “****” sh.p.k., për vitin 2017, janë në shumën 2.888.769,2 lekë, nga të cilat 50% janë arkëtuar nga subjekti (në llogarinë bankare të tij) dhe 50% kanë shkuar për shlyerje investimi, pronësinë e të cilit subjekti (do ta gëzojë) do të fitojë titullin e pronësisë pas kalimit të afatit prej 25 vjetësh.

47.7 Nga aktiviteti privat (lavazh/bar-kafe), djali i subjektit, z. ***.***, ka përfituar 1.496.173 lekë.

47.8 Në total, përfitimet financiare për vitin 2017 nga kjo marrëdhënie juridiko-civile arrijnë në shumën prej 4.384.942,20 lekë, duke zënë rreth 70% të totalit të të ardhurave të familjes së subjektit për vitin 2017, paraqitur në formë tabelare në vijim.

Tabela. nr. 3 - Të ardhurat familjare të vitit 2017

Të ardhura nga qiraja nga “****”sh.p.k.	1.444.384,6
Të ardhura nga aktiviteti i djalit, ***.***/ lavazh/ bar-kafe	1.496,173
Të ardhura nga shlyerja e investimit “****”sh.p.k.	1.444.384,6
Totali i të ardhurave nga ***	4.384.942,2 lekë
Të ardhura nga pagat	1.944.000
Totali i të ardhurave familjare	6,328.942,20 lekë

48. Sa më lart, është aspekti financiar i kësaj marrëdhënie juridiko-civile, por elementi që është më i rëndësishëm, që duhet të gjejë adresim në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit, është vlerësimi i saj në raport me detyrimet etike të subjektit të rivlerësimit, si detyrime ligjore të tij, dhe analizimi nëse jemi përballë cenimit të tyre.

48.1 Kushtetuta në nenin 149/ç ka përcaktuar rastet e papajtuësishmërisë në ushtrimin e funksionit të magjistratit/prokuror, duke renditur si kriteret ndaluese: “...veprimtari tjetër shtetërore ose politike, si dhe me veprimtari profesionale, që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik ose shkencor”.

48.2 Ligji nr. 96/2016, në nenin 7 të tij, ka renditur si kriteret ndaluese, gjatë ushtrimit të funksionit të magjistratit, të tilla si: “...të administrojë, të drejtojë ose të ushtrojë ndikim në shoqëritë tregtare ose fitimprurëse, personalisht ose nëpërmjet përfaqësimit” dhe “të zotërojë në mënyrë pasive aksione ose pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, në të cilën veprimtaria e magjistratit është e ndaluar,

për shkak se mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, krijon konflikt interesi ose krijon përshtypjen që magjistrati është i njëanshëm ose i ndikuar ...”.

48.3 Gjithashtu, neni 4 i këtij ligji përcakton se: *“Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera, edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të Prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit...”.*

48.4 Papajtueshmëritë me detyrën e prokurorit kanë gjetur rregullim edhe në urdhrin nr. 141, datë 19.6.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, në fuqi para se ligji nr. 96/2016 të fillonte veprimin.

48.5 Sipas nenit 4, paragrafi 1, shkronjat “ç” dhe “d” i “Rregullave mbi etikën”, parashikohet se prokurorët duhet: *“ç) Të mos zhvillojnë veprimtari ekonomike, përfshirë çdo lloj pune apo biznesi për të përfituar interesa materialë ose jomaterialë, që mund të ndikojnë në pavarësinë e tyre, ose që mund të krijojnë përshtypjen e përdorimit të detyrës për interesat e tyre ose personave të tjerë... dhe “d) Të mos ndikohen nga interesat e grupeve të caktuara⁴⁵”.*

48.6 Në analizë të detyrimeve ligjore si më sipër, është e qartë se ka elemente të mjaftueshme për të konkluduar se marrëdhënia kontraktuale e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “****” sh.p.k. bie ndesh me detyrimet ligjore etike të tij, të tilla që mjaftojnë për t’u interpretuar si fakte papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të prokurorit në rastin konkret.

48.7 Dispozitat e mësipërme ligjore dhe nënligjore janë të natyrës ndaluese dhe respektimi i tyre duhet të gjejë zbatim pa ekuivokë, në sjelljen dhe qëndrimin e çdo magjistrati, si në jetën profesionale dhe atë personale të tij.

48.8 Referuar dhe përmbajtjes së rekomandimit të paraqitur në rastin konkret nga përfaqësuesit e ONM-së, Komisioneri Publik ndan të njëjtin qëndrim se magjistratët, përveç respektimit dhe zbatimit të ligjit si çdo qytetar tjetër, pritet të sillen me integritet, mirësjellje, duke përmbushur standardet më të larta etike, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu dhe në jetën private. Ruajtja e integritetit të figurës së magjistratit lidhet pazgjidhshmërisht më ruajtjen në çdo rrethanë të ndershmërisë dhe dinjitetit në jetën private dhe atë publike.

48.9 Nuk është e thjeshtë të saktësohet përmbajtja e këtyre parimeve dhe as ekziston një përkufizim i tillë shterues, pasi rregullat e etikës nuk janë të natyrës ezauruese dhe gjithnjë të përcaktuara në mënyrë të plotë. Ato janë çështje të perceptimit dhe ndjeshmërisë ndaj paraqitjeve që magjistrati duhet vazhdimisht të mbajë në konsideratë, për të ruajtur legjitimitetin në ushtrimin e detyrës së tij.

⁴⁵ Për më tepër, neni 11 i rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve ndalon përfitimet ose trajtimin preferencial për prokurorët dhe vendos për ta rregullat mbi konfliktin e interesit, parashikuar nga ligji mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

48.10 Pikërisht për të shmangur këtë gjendje apo perceptim mbi pavarësinë, etikën, integritetin dhe paanshmërinë e magistratit, legjislacioni i zbatueshëm ka parashikuar dhe faktet dhe rrethanat që do të krijonin papajtueshmëri me funksionin e magistratit. Pavarësisht nga shembujt që mund të ekzistojnë, ajo që rekomandohet në raste të tilla është zbatimi i testit të personit të arsyeshëm, të ndershëm dhe të informuar, që do të thotë të provosh: *“Se si një sjellje e veçantë do të perceptohej nga anëtarët e arsyeshëm, ndershëm dhe të informuar të komunitetit dhe nëse ky perceptim ka të ngjarë të zvogëlojë respektin për gjyqtarin ose gjyqësorin në tërësi⁴⁶”*.

48.11 Komisioneri Publik vëren se Komisioni në ushtrim të funksionit të tij rivlerësues, nuk arrin ndonjë konkluzion lidhur me detyrimet e etikës së subjektit dhe nuk arrin të identifikojë ekzistencën ose jo të ndonjë shkelje disiplinore në këtë rast, duke devijuar në arsyetime të paqarta dhe jobindëse, kur parashtron se: *“...vlerëson se marrëdhënia kontraktuale ekzistuese midis subjektit dhe “***” sh.p.k., ...ka prodhuar dhe po prodhon efekte të përfitimeve të ndërthurura financiare brenda familjes së subjektit, që mund të krijojnë dyshime mbi përfitimet për shkak të pozitës profesionale të z. Besnik Cani; ... Trupi Gjykses konsideron se sa më sipër mund të shkaktojë papajtueshmëri me funksionin e prokurorit⁴⁷ [...]”*

48.12 Komisioneri Publik ndan qëndrimin se ky arsyetim mund të konsiderohet si pamjaftueshmëri në vlerësimin e kufizimeve të parashikuara nga (i) ligji nr. 96/2016, dhe në mënyrë specifike neni 7 i tij, kufizimet për shkak të detyrës dhe (ii) Rregullores për Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve, në veçanti me detyrimin: *“të mos kryejë asnjë aktivitet ekonomik”* dhe/ose detyrimin: *“të mos ndikohet nga interesat e grupeve të caktuara”, siç përcaktohet me ligj... ”*.

48.13 Komisioni, megjithëse pranon prezencën (mund të jetë shkak⁴⁸), të shkaqeve që çojnë në përgjegjësinë e subjektit, por: *“...duke e kombinuar këtë rrethanë me mundësinë e shqyrtimit të saj nga një tjetër organ⁴⁹”*, e transferon çështjen organit për inspektimin e shkeljeve disiplinore, me qëllim caktimin e një mase në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

48.14 Në vlerësim të Komisionerit Publik, ky arsyetim i Komisionit, veç faktit se bazohet në ekzistencën e dyshimit që, në vend të kësaj, ai duhej të ishte shuar nga mekanizmi procedural i barrës së provës, në mënyrë të gabuar, në rastin konkret shmanget më së paku nga zbatimi i nenit 61, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

48.15 Edhe në këtë rast, në konsideratë të qëndrimit të Komisionerit Publik të shprehur më lart, (referohuni trajtimit në ankim mbi përdorimin e këtij parimi në pikën 33, për pasurinë nr.1) mbetet i paqartë këndvështrimi që trupa gjykesore e Komisionit ka lidhur me zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe vendit që ai zë në procesin e rivlerësimit⁵⁰.

⁴⁶ Shihni Komentarin mbi Parimet e Bangladorit, sjelljes së gjyqësorit konsideruar dhe si “Magna Carta” e etikës gjyqësore - aprovuar në 2002, dhe që mund të aplikohet *mutatis mutandis* për prokurorët.

⁴⁷ Referuar nën pikës iv-v, të f.18 të vendimit.

⁴⁸ Referuar nën pikës “v”, të f. 18 të vendimit.

⁴⁹ Referuar nën pikës “vi”, f. 18 e vendimit.

⁵⁰ Përdorur edhe në rastin për truallin dhe banesën në ***, analizën financiare, përfitimi i statusit të pastrehë.

49. Etika – Çështja “c” – “Dosja e procedimit penal nr.***, e vitit 2012, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të të pastrehut, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier, nr.14, datë 28.3.2013

49.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit (nisur mbi bazën e një artikulli në një portal mediatik online), ky i fundit ka administruar vendimin nr.14, datë 28.3.2013, të Këshillit Bashkiak Fier, “Për miratimin e listës me familjet e pastreha, që do të përfitojnë nga programi social i kredisë së lehtësuar nga shteti, për blerjen e banesave me kosto të ulët”⁵¹, nga ku figuron si përfituese edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***.***.

49.2 Nisur nga fakti se kjo periudhë përkon me (i) kohën kur subjekti i rivlerësimit ka qenë drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, (ii) regjistrimin dhe ecurinë e një procedimi penal ndaj anëtarëve të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Fier, rreth praktikave të ndjekura për përfitimin e kundërligjshëm të kredive të buta (Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 31, datë 9.7.2012), Komisioni ka administruar materialet e këtij procedimi penal, nga ku, ndër të tjera, ka rezultuar se:

- i. mbi bazën e kallëzimit të disa qytetarëve të Fierit, për paligjshmëri në ushtrimin e detyrës nga funksionarë bashkiakë, gjatë dhënies së kredive të buta për familje të pastreha, në fillim të muajit korrik 2012, është regjistruar kallëzimi penal nr.***/2012;
- ii. me vendimi e datës ***.7.2012, organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, marrë nga prokurori i çështjes ***.***;
- iii. vendimi i mosfillimit, pasi i kalon për miratim subjektit, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ky i fundit ia komunikon kallëzuesve me anë të shkresës së datës ***.9.2012;
- iv. duke mos qenë dakord me vendimin e mosfillimit të procedimit penal, kallëzuesit e ankimojnë vendimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe kjo e fundit, më datë ***.2.2013, prish vendimin e Prokurorisë Fier dhe urdhëron kryerjen e veprimeve të nevojshme hetimore;
- v. ndërkohë, më datë ***.10.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr.***, për veprën penale “Shpërdorim të detyrës”, kryer në bashkëpunim, dhe veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”;
- vi. pas shpalljes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë ***.2.2013, më datë ***.3.2013, nga ana e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, konkretisht subjekti i rivlerësimit, është marrë vendimi për bashkimin e procedimeve nr.***, datë ***.3.2013 dhe atij nr.***, datë ***.10.2012;
- vii. gjatë kësaj kohe, kallëzuesit i janë drejtuar sërish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë-padi, duke kërkuar ndryshimin e VKB-së Fier nr. 31/2012, kërkim mbi të cilin Gjykata me vendimin nr. ***, datë ***.3.2013, ka vendosur pranimin e padisë, duke disponuar pavlefshmërinë e aktit administrativ të Këshillit Bashkiak Fier dhe detyrimin e këtij të fundit për rinxjerrjen e aktit administrativ;

⁵¹ Por jo dosjen e plotë të kësaj praktike, pasi Bashkia Fier përgjigjet që nuk i disponon.

viii. veprimet hetimore të Prokurorisë Fier janë shtrirë gjatë harkut kohor 2012-2014, ku dhe çështja penale është dërguar për gjykim për veprën penale: “Shpërdorim detyre” dhe “Falsifikimit të dokumenteve”.

49.3 Për faktet e mësipërme, Komisioni, megjithëse arsyeton se: “... ky veprim mund të bjerë ndesh me etikën e magjistratit dhe të ketë cenuar figurën e magjistratit, si dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor..., në përfundim konkludon se: ... “në mungesë të provave ndërlidhëse me një ndikim të paligjshëm mbi Këshillin Bashkiak ose/dhe përfitim nga funksioni i drejtuesit të Prokurorisë, nuk mund të çojë në aplikimin e pikës 1, germa “c”, të nenit 58, të ligjit nr. 84/2016.”, duke vendosur kështu edhe në këtë rast, transferimin e çështjes pranë organit kompetent inspektues, për vlerësimin në harmoni me dyshimet e tjera profesionale dhe caktimin e një mase të mundshme disiplinore, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

50. Komisioneri Publik, në konsideratë edhe sa trajtuam më sipër në lidhje me etikën profesionale të subjektit të rivlerësimit për çështjen “a”, vlerëson se provat e administruara në rastin në fjalë duhet të detyronin Komisionin në arritjen e një tjetër përfundimi, sikurse ka konstatuar fillimisht, për shkelje të etikës në ushtrimin e detyrës, të cilat sjellin si pasojë cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

50.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, gjatë analizimit të këtij rasti, nëse jemi përballë shkeljes së etikës së magjistratit dhe rrethanave të përfitimit të padrejtë dhe jashtë kritereve ligjore për shkak funksioni, nuk marrin rëndësi provat ndërlidhëse midis subjektit dhe ndikimit apo jo të tij në Këshillin Bashkiak.

50.2 Elementi i rëndësishëm në analizimin e përmbushjes së standardit të etikës nga ana e subjektit në rastin konkret është vlerësimi tërësor i fakteve dhe i provave të administruara, që, nëpërmjet kalimit të barrës së provës, organi rivlerësues të tejkalojë nga çdo dyshim i arsyeshem nëse subjekti me veprimet apo mosveprimet e tij ka cenuar rregullat etike profesionale, figurën e magjistratit e, për rrjedhojë, besimin e publikut, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, rrethana të cilat në çmim të Komisionerit Publik, në rastin konkret, të çojnë në një rezultat të tillë. Referuar shpjegimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti, pretendimet e tij mbeten në nivel deklarativ dhe kontradiktore, si dhe nuk arrijnë të shpjegojnë bindshëm arsyet e aplikimit dhe fitimit të statusit të familjes së pastrehë, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

50.3 Komisioneri Publik, vlerëson të nënvizojë se, sipas këtij legjislacioni, që rregullon rastet e përfitimit, ndër të tjera dhe të kredive të buta, neni 4 i ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, përfitojnë strehim (i) individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe (ii) familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore⁵², të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) **nuk kanë në pronësi një banesë**, ndërkohë subjekti kishte në pronësi truall + banesë në ***, apartament dhe garazh, në rr. “****”, Tiranë.

⁵² Referuar deklaramentit të vendbanimit të subjektit pranë ILDKPKI-së, për deklaratat e pasurisë në vitet 2012-2013, vendbanimi deklarohet vazhdimisht rr. “****”, Tiranë, apartamenti i analizuar si pasuria nr.1 në këtë ankim.

b) **zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit**, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi; nuk rezulton për subjektin;

c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

Përfshihen në njërën nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni **vetëm ato familje**, që kanë të ardhura të pamjaftueshme, ndërkohë që të ardhurat familjare të subjektit kanë qenë disa herë mbi pragun ligjor përfitues.

50.4 Përmbushja e kriterëve të mësipërme ligjore, specifikohet më tej në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.8.2012⁵³, në fuqi kur është miratuar Vendimi i Këshillit Bashkiak Fier nr.14/2013. Sipas kriterëve të këtij akti nënligjor, pas fazës së parë, që përfshin aplikimin nga ana e subjekteve që kërkojnë të përfitojnë, klasifikimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit, seleksionimit të përfituesve, njoftimit, kalohet në fazën e dytë, ku familjet përfituese duhet të dorëzojnë dokumentacionin provues që mbështet aplikimin, ku ndër të tjera rezultojnë dokumentet:

- i. certifikatën e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare;
- ii. vërtetimin për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;
- iii. vërtetimin e të ardhurave neto të familjes;
- iv. dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- v. dokumentin nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes;
- vi. vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis, që mund të përdoret si e tillë;
- vii. vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës, se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi.

50.5 Referuar listës së dokumenteve të mësipërme, pavarësisht faktit të pretenduar të mosdisbursimit të kredisë së butë në favor të familjes së subjektit të rivlerësimit, familja e tij rezulton përfituese e kësaj të drejte jashtë kriterëve ligjore dhe, në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, se ai nuk ka pasur dijeni mbi aplikimin nga ana e bashkëshortes së tij dhe përfshirjes në listën e përfituesve të kredive të buta në mënyrë të jashtëligjshme, janë të pabazuara.

50.6 Në konsideratë të faktit se (i) procedimi penal rreth praktikave të ngjashme abuzive për trajtim me kredi të butë, është zhvilluar gjatë periudhës 2012-2014 nga ana e Prokurorisë që drejtonte subjekti; (ii) përfitimi i statusit të pastrehë rezulton në mars të vitit 2013, (iii) natyra e dokumentacionit që kërkohet nga ligji të dorëzohet nga çdo aplikues; (iv) si dhe shpjegimet kontradiktore të subjektit, teksa shprehet se kërkesa e bashkëshortes së tij “...ishte kushtëzuar nga

⁵³ Ky vendim ka shfuqizuar vendimin e mëparshëm të Këshillit të Ministrave nr. 53, datë 28.01.2005, i cili parashikonte (afërsisht) të njëjtat dokumente.

nevoja për të qenë më i pranishëm në familje, mundësia e paktë e transferimit në Tiranë, mundësia e likuiditeteve të nevojshme për të bërë të mundur blerjen e një banese në Fier⁵⁴, vijnë në kontradiktë me pretendimin e subjektit mbi mosdijeninë e tij për aplikimin për kredi nga ana e bashkëshortes së tij apo mospasjes së njohurive të duhura ligjore.

50.7 Si përfundim, në analizë të fakteve të mësipërme, Komisioneri Publik çmon se përfitimi jashtë kriterëve ligjore të statusit të pastrehë i familjes së subjektit, në qytetin e Fierit, ndërkohë që ky i fundit ushtronte funksionin e drejtuesit të Prokurorisë në këtë qytet, që po hetonte të njëjtët subjekte shtetërore për shpërdorim detyre dhe falsifikim dokumentesh në trajtimin e familjeve me kredi të buta, është rrjedhojë e përfitimit të padrejtë për shkak funksioni dhe bie ndesh me përmbushjen e standardeve të etikës profesionale. Komisioneri Publik, në ndryshim nga përfundimi i Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cenuar etikën e magjistratit (neni 61/4), e për rrjedhojë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (neni 61/5).

(ii) Lidhur me aftësitë profesionale

51. Çështja “b” - “Çështja me nr.***, e vitit 2006, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”

51.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit, mbi bazën e denoncimit nga publiku (shtetasi ***.***), sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, megjithëse ka rezultuar se:

- i. subjekti, si prokuror i çështjes, fillimisht, ka vendosur “*mosfillim të procedimit penal*” dhe vetëm pas kontrollit dhe urdhërimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵⁵, ka kryer veprimet hetimore dhe ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq;
- ii. subjekti ka shfaqur sjellje pasive ndaj çështjes, duke moskryer veprimet e nevojshme hetimore, administrim të gabuar të dosjes, vlerësim të gabuar të fakteve dhe referim të gabuar të bazës ligjore.

51.2 Edhe në këtë rast, Komisioni arsyeton se: “...*ka konstatuar mangësi në veprimtarinë hetimore të subjektit, por gjithsesi duke vlerësuar se z. Besnik Cani e arrin, së paku, nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale - duke pasur parasysh sa më lart, si dhe shkaqet e sipërpërmendura, në pikat e mësipërme, lidhur me problematikat e tjera të konstatuara në dosjet profesionale të denoncuar nga publiku - Trupi Gjyqësor çmon se edhe dosjet që lidhen me këtë procedim penal... i përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore*”.

52. Për Komisionerin Publik, ky konkluzion nuk i përgjigjet rrethanave të faktit konkret dhe është rezultat i zbatimit të gabuar të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Mbetet e paqartë metodologjia e përdorur nga Komisioni në arritjen e përfundimit se subjekti: “...*arrin më së paku nivelin minimal kualifikues*”, kur ndërkohë Komisioni ka konstatuar se subjekti shfaq modele të njëjta pune, të

⁵⁴ Referuar shpjegimeve të datës 20.11.2018, të subjektit, pas kalimit të barrës së provës.

⁵⁵ Gjykata në arsyetimin e saj përmend faktin se organi i prokurorisë nuk ka pasur parasysh provat dhe faktet që janë paraqitur nga kallëzuesi si dhe dy vendime me të njëjtin numër dhe datë por me përmbajtje të ndryshme.

përsëritura, me problematika të ngjashme dhe për dy raste të tjera të denoncuara⁵⁶. Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit të aftësive profesionale, kreu IV, i ligjit nr. 84/2016, referon te përmbajtja e dispozitave përkatëse të legjislacionit, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku për magjistratin prokuror i referohemi nenit 73 e në vijim të ligjit nr. 96/2016. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, nëse gjetjet dhe mangësitë e konstatuara do t'i nënshtroheshin vlerësimit sipas këtij kuadri rregullator, subjekti rezulton me mangësi të njëjta, të përsëritura për të paktën (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative dhe (iii) arsyetimin ligjor, shkaqe këto të cilat në vlerësimin e Komisionerit Publik çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

53. Çështja “d” - “Çështja me nr. *, e vitit 2015, regjistruar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan”**

53.1 Kjo çështje është zgjedhur për t'u vlerësuar mbi bazën e shortit. Nga shqyrtimi i dosjes se procedimi penal nr.***, datë ***.6.2015, është regjistruar për veprën penale “Kanosje e gjyqtarit”. Prokurori i çështjes ***.***, pasi ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, në përfundim ka vendosur ta dërgojë për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo vendimmarrje e prokurorit të çështjes ka kaluar për kontroll dhe konfirmim te drejtuesi i Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit. Rezulton se ky i fundit ka vendosur shfuqizimin e vendimit për dërgimin e dosjes penale nr. ***/2015 dhe kërkesës për gjykimin e çështjes penale.

53.2 Referuar analizës së kryer nga subjekti për shfuqizimin e këtij vendimi, konstatohen mangësi profesionale në kryerjen e hetimeve të thelluara, cilësim korrekt i veprës penale dhe referim i gabuar i dispozitës që gjen zbatim në rastin konkret.

53.3 Përtej pranisë së elementeve të figurës së veprës penale të kanosjes, fakt ky i pohuar edhe nga subjekti në arsyetimin e tij, rezulton se është injoruar prezenca e elementeve penale edhe për një vepër tjetër, atë të fyerjes, duke konsideruar gabimisht se ajo mund të ndiqet kryesisht nga i dëmtuari akuzues, sipas nenit 59 të K.Pr. Penale.

53.4 Marrë në konsideratë se pushimi i hetimeve, referuar kualifikimit të gabuar të veprës penale dhe arsyetimit ligjor, ndaj denoncimit të një prokurori, jepet nga drejtuesi i Prokurorisë, në kuadër të rivlerësimit të aftësive profesionale, ky fakt merr rëndësi dhe peshë edhe më të madhe. Edhe në këtë rast, Komisioni konkludon se: *“...- duke mbajtur parasysh faktin se gjithsesi, subjekti ka arritur, së paku, një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale - ky vendim, transferohet, në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljes disiplinore...”*

54. Komisioneri Publik, sërish, konstaton se mangësitë dhe problematikat e konstatuara në mënyrë të përsëritur edhe nga Komisioni, në rastet e mësipërme, bazuar në një vlerësim objektiv mbi kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, duhet të çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 4 dhe 5, e ligjit nr. 84/2016.

⁵⁶ Denoncim nga shtetasi ***,***, shtetasi ***,***.

55. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në rastin konkret, Komisioni bazuar në një interpretim të gabuar të nenit 59, pikat 1, 2, 3, dhe 4, lidhur me nenin 61, pika 4 apo pika 5, e ligjit nr. 84/2018, vendos transferimin e katër çështjeve organit inspektues.

56. Nisur nga specifikat e hetimit dhe vendimmarrjes së Komisionit, të pasqyruara në arsyetimin dhe dispozitivin e vendimit nr. 84/2018, duke mbetur i bindur, Komisioneri Publik, se çështjet e transferuara tek organi disiplinor, në rastin konkret duhen konsideruar se përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e nenit 61, pika 4 dhe 5, por në konsideratë të rolit kontrollues dhe orientues, sipas nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, për të rregulluar ecurinë e mëtejshme të procesit të rivlerësimit, në kuptim të zbatimit të nenit 59/a, të ligjit nr. 84/2016, merr shkak t'i kërkojë Kolegjit të marrë në shqyrtim dhe të shprehet për çështjet si vijojnë:

- (i) A mundet Komisioni të heqë dorë nga juridiksioni i tij rivlerësues në lidhje me kriterin profesional, kur sipas Kushtetutës, aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, është kompetencë e plotë dhe detyrë e tij (Komisionit) kryerja e rivlerësimit kalimtar të subjekteve për qëllim të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës. Përpara se Komisioni t'ia transferojë çështjet një tjetër organi kompetent për inspektim, kjo vendimmarrje a duhet të udhëhiqet nga një proces paraprak vlerësimi lidhur me plotësimin e kushteve që neni 59/4 i ligjit kërkon, si “evidentimin e shkaqeve që përbëjnë shkelje disiplinore” apo “shkaqeve për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit”?
- (ii) Në çdo rast, kjo lloj vendimmarrje e Komisionit sipas nenit 59/4, të ligjit nr. 84/2016, a do të duhet të kufizohet në lidhje me numrin e çështjeve/praktikave që mund t'i transferohen organit kompetent për inspektim?

57. Në mbështetje të parashtrimit të këtyre çështjeve që mund të vlerësohen nga Kolegji për t'u trajtuar, në zbatim të kompetencës së tij orientuese, vlen të theksohet se në disa vendime të mëparshme, Komisioni ka referuar më së shumti një çështje tek organi kompetent inspektues, ndërsa në rastin objekt ankimi, ka vendosur transferimin e 4 çështjeve/praktikave, duke përjashtuar në këtë mënyrë zbatimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me nenin 4, pika 2 e tij.

58. Është në vlerësimin e Komisionerit Publik se, për të shmangur rrezikun e transferimeve *apriori* të çështjeve tek organi kompetent për inspektim, ligjvënësi ka parashikuar që organi rivlerësues (Komisioni) duhet që të bindet dhe arsyetojë paraprakisht nëse rezultatet e dala nga hetimet administrative të tij nuk përbëjnë lëndë vlerësimi për qëllim të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, nenit E, të aneksit apo nenit 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, pasi në tilla rrethana, nga vlerësimi tërësor i çështjes, është e qartë se neni 59/1 (i cili aktivizon 59/4) i këtij ligji nuk gjen hapësirë dhe neni 65/1 merr përparësi zbatimi.

III. Kërkimi i ankimit

59. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

60. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

61. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtuar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

62. Bazuar në nenin Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34, 40-44, pikës 3, 4 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

63. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zotit Besnik Cani.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi nr.78/1 prot., datë 25.01.2019, i ONM-së;
2. Opinioni nr. 1465 prot., datë 25.10.2018, i ONM-së.